

# **RAPORT PËR MONITORIMIN E PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2018**

---



# **RAPORT PËR MONITORIMIN E PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2018**



COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10 000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Layout and design: **envinion**

**Shënim:** Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Kuvendit përgjatë vitit 2018, dhe është realizuar në kuadër të projektit "Rritja e Pjesëmarrjes, Transparencës dhe Llogaridhënies në Kosovë", financuar nga Fondi për Demokraci i Kombeve të Bashkuara (UNDEF). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e donatorit.




# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>4</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>5</b>
<b>1. HYRJE.....</b>	<b>7</b>
<b>2. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE .....</b>	<b>8</b>
<b>3. ANALIZA E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE .....</b>	<b>12</b>
<b>4. MBARËVAJTJA E SEANCAVE PARLAMENTARE .....</b>	<b>15</b>
4.1. Seancat plenare.....	16
4.2. Seancat e jashtëzakonshme .....	16
4.3. Seancat solemne.....	16
4.4. Debatet parlamentare.....	16
4.5. Pjesëmarrja e deputetëve në seanca .....	17
4.6. Lëvizjet e deputetëve nëpër Grupe Parlamentare.....	20
<b>5. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE.....</b>	<b>21</b>
5.1. Pyetjet Parlamentare.....	21
5.2. Raportimi i ministrave në Komisione Parlamentare .....	27
5.3. Interpelancat.....	27
5.4. Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura.....	29
5.5. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve.....	29
<b>6. SHPENZIMET E KUVENDIT .....</b>	<b>31</b>
<b>7. UDHËTIMET E DEPUTETËTVE JASHTË VENDIT .....</b>	<b>32</b>
<b>8. REKOMANDIMET .....</b>	<b>36</b>
<b>SHTOJCAT .....</b>	<b>37</b>
SHTOJCA 1 – Analizë e punës së Komisioneve Parlamentare .....	37
SHTOJCA 2 - Pjesëmarrja e deputetëve në Komisione Parlamentare.....	45
SHTOJCA 3 – Pjesëmarrja e deputetëve në seanca plenare.....	52



# LISTA E SHKURTESAVE

<b>6+</b>	Grupi Parlamentar 6+
<b>AAK</b>	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
<b>AKA</b>	Agjencia Kosovare për Akreditim
<b>AKI</b>	Agjencia Kosovare e Intelegjencës
<b>AKR</b>	Aleanca Kosova e Re
<b>EQAR</b>	Agjencia Evropiane për Sigurim të Cilësisë në Arsimin e Lartë
<b>ERA</b>	Agjenda për Reforma Evropiane
<b>FFK</b>	Federata e Futbollit të Kosovës
<b>FSK</b>	Forca e Sigurisë së Kosovës
<b>GP</b>	Grup Parlamentar
<b>KDI</b>	Instituti Demokratik i Kosovës
<b>KPM</b>	Komisioni i Pavarur për Media
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>LDK</b>	Lidhja Demokratike e Kosovës
<b>LS</b>	Lista Serbe
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
<b>NISMA</b>	Nisma Social Demokrate
<b>OJQ</b>	Organizatë Jo-Qeveritare
<b>PKZMSA</b>	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
<b>PSD</b>	Partia Social Demokrate
<b>RTK</b>	Radio Televizioni i Kosovës
<b>SHSKUK</b>	Shërbimimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
<b>VV</b>	Vetëvendosje



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka shënuar ngritje në performancë, në krahasim me vitet e kaluara.<sup>1</sup> 42 seanca të Kuvendit dhe 437 mbledhje të komisioneve parlamentare i kanë mundësuar organit më të lartë ligjvënës përmbushjen e agjendës legjislative në masën prej 42%, që është rritje prej 6% në krahasim me vitet 2015 dhe 2016.

Përkundër kësaj, punën e Kuvendit në vitin 2018 e ka karakterizuar mungesa e kuorumit e cila ka bllokuar vendimmarrjen në shumicën e seancave plenare dhe ka detyruar kryesuesin e seancës të shtyjë punimet. Si rrjedhojë, shumë pika të papërfunduara të rendit të ditës nga seanca të ndryshme janë grumbulluar dhe vendosur në agjendën e një seance të vetme, fenomen ky që është përsëritur vazhdimisht përgjatë vitit.

Kuvendi në agjendën e vet legjislative për vitin 2018 kishte paraparë 176 projektligje, e cila përfshin projektligjet e planifikuar në agjendën e Qeverisë, nismat legjislative nga Kuvendi si dhe projektligjet e bartura nga agjenda legjislative e vitit paraprak. Një nga dobësitë e legjislaturave të kaluara kanë qenë numri i vogël i nismave legjislative nga Kuvendi, e cila duket sikur është tejkaluar gjatë vitit 2018 kur shënohet një trend i rritjes së iniciativave ligjore nga ana e Kuvendit të Kosovës me gjithsej 16 të tilla gjatë tërë vitit. Nga nismat e propozuara nga Kuvendi, tri janë miratuar, nëntë janë ende në procedurë të shqyrtimit ndërkaj katër prej tyre janë në pritje të shqyrtimit. Përkundër bojkotimit të pjesshëm të punës së Kuvendit nga subjektet opozitare, deputetët e opozitës kanë votuar shumicën dërmuese të tyre. 38 nga 75 ligjet e miratuara këtë vit janë ligje që derivojnë nga Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit (MSA); Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) dhe marrëveshje

ndërkombëtare të votuara edhe nga subjektet në opozitë. Pjesa tjetër e projektligjeve, ndonëse ishte miratuar pa votat e LDK dhe VV, ishin votuar për shkak se kuorumi ishte mundësuar nga grupi i tretë opozitar – PSD.

Miratimi i ligjeve është përcjellë shpeshherë me shkelje të Rregullores së Punës së Kuvendit. Edhe pse Rregullorja përcakton se amendamentet votohen si të veçanta, në raste të shpeshta ato janë votuar në grup, siç është rasti me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Po ashtu, Kuvendi edhe këtë vit ka vazhduar me praktikën e shqyrtimit të projektligjeve në procedurë të përsheptuar, sipas të cilës janë miratuar 11 ligje, përfshirë këtu Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik. Numri i dëgjimeve publike për shqyrtimin e projektligjeve këtë vit është shumë i vogël në raport me numrin e ligjeve që janë miratuar. Për 75 ligje të miratuara (përfshijto këtu 19 marrëveshje ndërkombëtare), Kuvendi ka organizuar dëgjime publike për vetëm 12 prej tyre ndërsa 44 ligje të tjera janë shqyrtuar dhe miratuar pa konsultim me publikun.

Kuvendi, gjatë periudhës raportuese, ka qenë aktiv në mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit. Janë iniciuar 12 interpelanca nga opozita, dhe 19 debate parlamentare, numër ky më i madh krahasuar me vitet paraprake kalendarike ndër legjislatura. Gjatë këtij viti janë shtruar 275 pyetje parlamentare dhe vetëm 61% prej tyre kanë marrë përgjigje nga kabinetit qeveritar. Zyrtarët ekzekutivë kanë raportuar 81 herë para komisioneve parlamentare. Mbikëqyrja e 34 institucioneve të pavarura që i raportojnë drejtpërdrejtë Kuvendit mbetet problematike. Kuvendi ka shqyrtuar 26 raporte të institucioneve të pavarura.

<sup>1</sup> Në raport nuk është bërë krahasimi i punës së Kuvendit mes vitit 2018 dhe 2017 të Legjislaturës së VI-të për shkak se gjatë vitit 2017 kanë funksionuar dy Legjislatura (V dhe VI).

Komisionet Parlamentare në tërësi janë mbledhur 437 herë, prej të cilave 414 në mbledhje të rregullta të komisionit dhe në 23 dëgjime publike. Sa për krahasim, gjatë vitit 2016, komisionet parlamentare kishin realizuar 362 mbledhje të rregullta dhe 21 dëgjime publike.

Kuvendi ka shënuar regres në transparencë financiare duke publikuar vetëm raportin financiar për nëntëmujorin e vitit 2018, i cili flet për 300 udhëtime jashtë vendit me një kosto prej 239,039.65 €. Vetëm për periudhën prill – qershor 2018, shpenzimet e deputetëve në udhëtime jashtë vendit janë rritur për 86% në krahasim me tremujorin e parë të vitit dhe nga to kanë përfituar 87 nga 120 deputetë. Këto raporte gjithashtu nuk ofrojnë informacione lidhur me qëllimin e vizitave të deputetëve dhe kohëzgjatjen e tyre.

Karakteristikë e funksionimit të Kuvendit gjatë vitit 2018 ishte edhe mospjesëmarrja e subjekteve opozitare në punimet e Kuvendit. Bojkoti opozitar është intensifikuar nga muaji qershor, prej kur një pjesë e opozitës, sidomos GP LDK dhe VV kanë bojkotuar pjesërisht punën e Kuvendit. Deputetët e LDK-së dhe VV-së kanë kontribuar aktivisht në shqyrtimin e projektligjeve dhe raporteve të ndryshme nëpër komisione parlamentare, por të njëjtën nuk e kanë bërë në seanca plenare. Pjesa tjetër e opozitës, gjegjësisht PSD-ja, së bashku me dy deputetët e Alternativës, janë treguar më konstruktiv ndaj kërkesave të pozitës për pjesëmarrje në punimet e Kuvendit dhe bërjen e kuorumit për zhvillimin e seancave plenare. Arsyet e mospjesëmarrjes së opozitës në punimet e Kuvendit kishin kryesisht karakter politik, duke u përpjekur të dërgojnë mesazhin se koalicioni qeverisës nuk e ka shumicën e nevojshme për të kryer punët në Kuvend. Në disa raste, bojkoti është shfaqur edhe si reflektim i raporteve të tensionuara mes pozitës dhe opozitës, kryesisht pas diskutimeve të ashpra mes deputetëve dhe pamundësisë së arritjes së konsensusit politik dhe plotësimit të disa kërkesave të deputetëve opozitar.

Problemit të sigurimit të numrave në Kuvend i ka kontribuar edhe bojkoti i Listës Serbe. Si partner i koalicionit qeverisës, LS në vazhdimësi ka treguar mungesë të konsistencës në punën e saj në Kuvend, duke shënuar pjesëmarrje të ulët në punimet e Kuvendit. Bojkoti i LS ndaj Kuvendit u zyrtarizua pas arrestimit të Koordinatorit të të ashtuquajturës Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq. Ndonëse deputetët e LS nuk morën pjesë në seanca, ata morën pjesë në punimet e komisioneve parlamentare. Lista Serbe përfundimisht e bojkotoi punën e Kuvendit pas vendosjes së tarifës 100% nga Qeveria e Republikës së Kosovës për produktet serbe dhe boshnjake. Që nga ky moment, deputetët e Listës Serbe nuk kanë marrë më pjesë në punimet e Kuvendit, qoftë në seanca plenare apo komisione parlamentare.

Një zhvillim tjetër në punën e Kuvendit gjatë vitit 2018 ishte edhe ndarja e GP të Lëvizjes Vetëvendosje dhe krijimi i grupit të ri parlamentar nga Partia Socialdemokrate (PSD). Lëvizja Vetëvendosje kishte fituar 32 mandate në zgjedhjet e mbajtura në vitin 2017 dhe ishte grupi më i madh parlamentar. Krijimi i GP të PSD-së ka ndikuar direkt në konstelacionin e forcave mes forcave politike në Kuvend, sidomos të atyre në opozitë. Nga situata e krijuar në GP të Lëvizjes Vetëvendosje, GP i LDK-së mori primatin si grupi më i madh parlamentar në Kuvend. Për më tepër, 12 deputetët e shkëputur nga GP i VV-së kanë ndikuar direkt në punën e Kuvendit, duke u bërë pjesë aktive e punimeve në Kuvend, qoftë duke votuar projektligjet e parapara në seanca plenare apo duke e mundur kuorumin e nevojshëm për votimin e pikave të rendit të ditës.

# 1. HYRJJE

Pas 12 vitesh monitorim të rregullt të punës së Kuvendit, KDI tanimë ka krijuar një qasje tjetër të monitorimit duke përfshirë qytetarët, shoqërinë civile, studentët dhe grupe të tjera të interesit. Qëllimi i monitorimit të udhëhequr nga qytetarët është të sigurojë qëndrueshmëri në monitorimin e punës së Kuvendit nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të studentëve, OJQ-ve në nivel lokal dhe komunitetin e aktivistëve që të monitorojnë punën e Kuvendit dhe të përcjellin zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga vet ata. Nëpërmjet përfshirjes aktive të qytetarëve në monitorimin parlamentar synohet që Kuvendi i Kosovës dhe deputetët të avansojnë llogaridhënien parlamentare, të rrisin përfaqësimin dhe transparencën ndaj zgjedhësve.

Ky raport paraqet vlerësimin e punës së Kuvendit për vitin 2018. Gjatë periudhës raportuese, KDI ka përcjellë në mënyrë aktive mbarëvajtjen e punimeve të Kuvendit dhe përputhshmërinë me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Raporti përmban të dhëna statistikore që janë mbledhur nga monitoruesit e KDI-së, të cilët kanë përcjellë të gjitha mbledhjet e komisioneve parlamentare, Kryesisë së Kuvendit si dhe seancat plenare. Këto të dhëna janë analizuar dhe prezantuar në mënyrë të detajuar, për të pasqyruar drejtë dhe saktë punën e Kuvendit. Përmes monitorimit të punës së Kuvendit, KDI synon të rrisë efikasitetin, transparencën si dhe llogaridhënien e institucionit më të lartëligjvënës karshi qytetarëve.

Fillimisht raporti analizon punën e komisioneve parlamentare, më saktësisht vlerësimin e përmbushjes së planeve të tyre të punës. Më tutje, raporti trajton mbarëvajtjen e seancave, përmbushjen e agjendës legjislative si dhe dinamikën e miratimit të ligjeve. Raporti poashtu përfshin mbikëqyrjen parlamentare, udhëtimet jashtë vendit si dhe shpenzimet e Kuvendit. Përmes shtojcave, ky raport paraqet në mënyrë të detajuar edhe pjesëmarrjen dhe mungesat e deputetëve në punimet e Kuvendit, qoftë në seanca plenare apo në mbledhje të komisioneve parlamentare.





## 2. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE

Me fillimin e punimeve të sesionit pranveror, Komisionet Parlamentare kanë hartuar planet e punës për vitin 2018. Në bazë të planifimeve të Komisioneve dhe plan – programit legjislativ të Qeverisë, Kryesia e Kuvendit ka përgatitur plan – programin e punës së Kuvendit për vitin 2018 i cili kishte arritur që të marrë miratim final në seancë plenare në fund të muajit mars.

Programi legjislativ i Kuvendit si pjesë e plan – programit të punës së Kuvendit është hartuar bazuar në Projektligjet e bartura nga sesioni vjeshtor i vitit paraprak, programit legjislativ të Qeverisë si dhe nismat legjislative që janë paraparë në planet e punës së Komisioneve.

Programi legjislativ i Kuvendit për vitin 2018 ka përbajtur gjithsej 113 projektligje, por që në ndërkohë këtij plani i janë shtuar edhe 63 ligje që nuk kanë qenë të përfshira në planin fillestar duke çuar kështu numrin në 176 ligje për t'u shqyrtuar gjatë këtij viti. Nga këto projektligje, në sesion pranveror janë miratuar 33 ligje (22%), ndërkaq 42 tjera u miratuan në sesion vjeshtor duke përbushur kështu 42% të agjendës legjislative për këtë vit. Në procedurë të shqyrtimit kanë mbetur edhe 55 projektligje (31%) përdërisa 46 (27%) të tjera nuk janë dorëzuar në Kuvend nga Qeveria.

**46 (27%)**  
projektligje në pritje



FIG. 1

Përbushja  
e agjendës  
legjislative gjatë  
vitit 2018



**75 (42%)**  
ligje të miratuara

**55 (31%)**  
projektligje në  
procedurë






# 17

LIGJE NË PLOTËSIM - NDRYSHIM



# 58

LIGJE TË REJA




**FIG. 2** Llojet e ligjeve të trajtuara nga Kuvendi gjatë vitit 2018

Nga 75 ligjet e miratuara këtë vit, prej tyre 17 ligje janë plotësim ndryshim i ligjeve ekzistuese ndërsa 58 të tjera janë ligje të reja. Nga tërësia e ligjeve të miratuara 18 janë ligje për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare, nga të cilat pesë janë marrëveshje me karakter financiar.

Inicimi i nismave ligjore nga ana e Kuvendit ka qenë sfiduese për këtë institucion ndër legjislatura. Mirëpo ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit Kuvendi ka qenë më i frytshëm në nisma ligjore duke. Nga 16 sa janë propozuar vetëm 3 janë miratuar, Ligji për ndryshim – plotësimin e Ligjit për Familjen, Ligji për Kompleksin memorial 'Adem Jashari' në Prekaz dhe Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në procedurë të shqyrtimit kanë mbetur edhe 9 prej tyre, ndërkaq 4 të tjera kanë mbetur në pritje për t'u shqyrtuar.

Marrë parasysh prioritetet e Qeverisë për reformën e ndërmarrë në sistemin e drejtësisë në kuadër të përbushjes së agjendës evropiane, numri më i madh i ligjeve të miratuara i përket sektorit të drejtësisë, ku prej numrit të përgjithsëhm të ligjeve të miratuara 15 i takojnë këtij sektori. Në sektorin e financave janë miratuar 9 ligje, nancave (9), pasuar nga sektori i punëve të brendshme (5), arsimit (5), komunikacionit (5), tregti (5), administratës (4), ekonomisë (4), sigurisë (3), social (3), mjedisit (2), infrastrukturës (2), shërbimeve publike (2), planifikimit hapësinor (2), metalurgjisë (2), kulturës (1), shëndetësisë (1), energjisë (1), punëve të jashtme (1), qeverisjes lokale (1), inxhinierisë (1), anti korrupsionit (1).






FIG. 3 Ligjet e miratuara në vitin 2018, të ndara sipas sektorëve

Një karakteristikë e këtij viti ka qenë numri i madh i projektligjeve të proceduara nga Qeveria në Kuvend por që e njëjta dinamika e punës nuk është përcjellë edhe në Kuvend ku për shkak të mungesë të kuorumit është zvarritur procesi i shqyrtimit të tyre. Numri i madh i ligjeve të miratuara këtë vit ka ardhur kryesisht si rezultat i përmbushjes së obligimeve që kanë rrjedh nga ARE-ja dhe MSA-ja si dhe marrëveshjet ndërkombëtare me karakter financiar, Nga 38 prej 75 ligje të miratuara gjithsej janë ligje që derivojnë nga MSA ose ARE si dhe marrëveshje ndërkombëtare. Ndonëse krahasuar me legjislaturën e V-të numri i ligjeve të miratuara është më i madh, procesi i shqyrtimit dhe miratimit të tyre është përcjellë me shumë probleme.

Ligjvënia është përcjellë me shumë sfida, siç janë mungesa e kuorumit të kuorumit, mospjesëmarrje e deputetëve në votim përkundër pranisë së tyre fizike në sallë gjë që ka shkakuar vonesa në ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, shkelje të procedurave në votimin e ligjeve në tërësi pa i votuar secilin amendament, shqyrtimin e projektligjeve me procedurë të përshpejtuar, amendamentimin e projektligjeve gjatë leximit të dytë në seancë.

Opozita ka pasur rol kyç në procesin ligjvënës për shkak të mungesës së numrave nga shumica parlamentare posaqërisht në miratimin e projektligjeve që kërkonin votat e shumicës së deputetëve. Vetëm atëherë kur opozita kishte vendosur që të kthejë në seanca në rastet kur ka marrëveshje ndërkombëtare për shkak të rëndësisë së tyre, marrëveshjet kanë arritur që të miratohen. Tri nga marrëveshjet e sjella për ratifikim nga Qeveria, i janë kthyer mbrapa Qeverisë pasi që nuk kishin arritur të marrin numrin e nevojshëm të votave të deputetëve.

Edhe në rastet kur kërkohej shumicë e thjeshtë e votave për të kaluar projektligjet me theks ato që lidheshin me procesin e liberalizimit të vizave dhe ARE-së ka qenë opozita ajo që e ka mundësuar kuorumin në votim për t'u votuar ato projektligje.

Kuvendi edhe këtë vit ka vazhduar me praktikën e shqyrtimit të projektligjeve në procedurë të përshpejtuar, ku 11 nga ligjet e miratuara janë shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar, projektligje këto që kanë qenë pjesë e obligimeve të dala nga ARE-ja e që për shkak të vonesave në shqyrtimin e tyre i janë nënshtruar procedurave të përshpejtuara. Dy Ligje janë kthyer nga Presidenti për rishqyrtim të neneve të caktuara që sipas zyrës së Presidentit përbënin shkelje ligjore.



Opozita ka pasur rol kyç në procesin ligjvënës për shkak të mungesës së numrave nga shumica parlamentare posaqërisht në miratimin e projektligjeve që kërkonin votat e shumicës së deputetëve. Vetëm atëherë kur opozita kishte vendosur që të kthejë në seanca në rastet kur ka marrëveshje ndërkombëtare për shkak të rëndësisë së tyre, marrëveshjet kanë arritur që të miratohen.



# 3. ANALIZA E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

**P**ërkundër bojkotimit të seancave plenare, sidomos në sesionin vjeshtor, deputetët e opozitës kanë vazhduar punën në komisionetpërkatëse. Edhe në komisione, mungesa e kuorumit, ndonësemë pak e theksuar se në seanca, ka bërë që disa mbledhje të dështojnë.

Komisionet parlamentare në tërësi kanë realizuar 414 mbledhje të rregullta dhe 23 dëgjime publike. Krahasuar me 2016, volumi i mbledhjeve të komisioneve është rritur për 15% (nga 362 në 414) ndërsa ai i dëgjimeve publike ka mbetur i njëjtë (23). Në kuadër të aktiviteteve mbikëqyrëse, komisionet parlamentare gjatë vitit 2018 kanë ftuar për raportim 66 herë ministrat e kabinetit qeveritar, numër ky më i madh sesa në vitet 2015 dhe 2016. Poashtu, një nga dobësitë e legjislaturave të kaluara kanë qenë nismat legjislative nga ana e Kuvendit, mirëpo gjatë vitit 2018 ka pasur trend të rritjes së iniciativave ligjore nga ana e deputetëve. Vetëm gjatë këtij vitit janë inicuar gjithsej 15 nisma legjislative, prej të cilave 7 janë inicuar nga komisionet parlamentare.<sup>2</sup>


Ndonëse Rregulloja e Punës së Kuvendit obligon Komisionet Parlamentare të mbajnë së paku dy mbledhje brenda muajit<sup>3</sup>, kjo dispozitë rrallë herë është respektuar nga komisionet. Komisionet me më së shumti mbledhje të realizuara ishin: Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi (48), i pasuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri

dhe Zhvillim Rajonal (46) dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit (38). Komisionet me së paku mbledhje të realizuara gjatë vitit ishin Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së (14), Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së (22) dhe Komisioni për Integritet Evropian (22).

Duke pasur parasysh se dëgjimet publike janë një nga mënyrat me anë të së cilave garantohej përfshirja e qytetarëve dhe grupeve të caktuara të interesit në procesin ligjvënës, ky mekanizëm ka mbetur në masë të madhe i pashfrytëzuar nga ana e komisioneve parlamentare. Komisionet parlamentare kanë realizuar numër shumë të vogël të dëgjimeve publike. Në tërësi janë mbajtur vetëm 23 dëgjime publike nga të gjitha Komisionet Parlamentare. Nga 75 ligjet e miratuara nga Kuvendi, vetëm për 12 prej tyre janë organizuar dëgjime publike nga ana e Komisioneve Parlamentare. Ky fenomen është shfaqur në masë të madhe për shkak të urgjencës së miratimit të disa projektligjeve në procedura të përshpejtuara, kryesisht atyre që ndërlihen me përmblidhjen e obligimeve evropiane. Në këtë aspekt, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit ka realizuar numrin më të madh të dëgjimeve publike (5), ndjekur nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal; Komisioni për Arsim, Shkencë,

<sup>2</sup>Tri nisma ligjore janë inicuar nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, dy nisma ligjore janë inicuar nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor; kurse nga një nisë ligjore kanë inicuar Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së si dhe Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

<sup>3</sup> Rregulloja e Punës së Kuvendit, neni 64(5)



Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media me nga 3 dëgjime publike. Pesë komisione parlamentare nuk kanë realizuar asnjë dëgjim publik.<sup>4</sup>

Mungesat dhe vonesat të deputetëve në mbledhjet e komisioneve shpesh kanë pamundësuar kuorumin dhe mbarëvajtjen e punimeve. Në tërësi, deputetë kanë shënuar 1249 mungesa vetëm në angazhimin e tyre në komisione parlamentare.

Komisionet Parlamentare nuk kanë performuar mirë në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Vetëm katër ligje janë monitoruar nga të gjitha komisionet parlamentare, prej të cilëve vetëm një ka përfunduar, kurse për tre të tjerë kanë përfunduar raportet e monitorimit por që të njëjta nuk janë proceduar për miratim në seancë gjatë periudhës raportuese. Shumica e komisioneve në planet e tyre të punës kishin planifikuar monitorimin e zbatimit të ligjeve, por ky planifikim nuk ka arritur të realizohet.

Fenomen tjetër i shfaqur gjatë punës së komisioneve gjatë vitit 2018 ishin edhe ndërrimet e shpeshta të anëtarëve/eve nëpër komisione parlamentare. Pas ndarjes së Grupit Parlamentar të VV-së, në muajin qershor ka pasur zëvendësime të deputetëve në të gjitha komisionet. Poashtu, edhe largimi i dy deputetëve të Alternativës nga GP LDK ka ndikuar që të ketë lëvizje të deputetëve edhe në muajin nëntor. Grupet Parlamentare poashtu kanë bërë zëvendësimin e deputetëve në disa komisione. Këto lëvizje kanë ndikuar negativisht në punën e komisioneve, pasi që nuk ka pasur kontinuitet të punës së këtyre deputetëve nëpër komisionet përkatëse. Për më tepër, për shkak të mungesës së kuorunit në seanca plenare, procesi për zëvendësimin e deputetëve nëpër komisione është tejzgjatur dhe ka ndikuar në përbërjen e komisioneve.



Mungesat dhe vonesat e deputetëve në mbledhjet e komisioneve shpesh kanë pamundësuar kuorumin dhe mbarëvajtjen e punimeve. Në tërësi, deputetë kanë shënuar 1249 mungesa vetëm në angazhimin e tyre në komisione parlamentare.

<sup>4</sup> Komisionet që nuk kanë organizuar asnjë dëgjim publik janë Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim; Komisioni për Integritet Evropian; Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike; Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe Komisioni për Mbikëqyrja e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë

Emërtimi i komisionit	Mbledhje të mbajtura	Dëgjime Publike	Projektigje të trajtuara	Orët e punës	Mungesa të deputetëve
<b>Buxhet dhe Financa</b>	28	1	63 <sup>5</sup>	33.40	69
<b>Të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim</b>	24	0	74 <sup>6</sup>	16.36	74
<b>Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit</b>	38	5	63 <sup>7</sup>	58.07	127
<b>Integrime Evropiane</b>	22	0	76 <sup>8</sup>	24.10	33
<b>Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike</b>	27	0	1	36.18	76
<b>Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi</b>	48	3	18	68.36	154
<b>Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal</b>	46	3	20	46.41	163
<b>Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor</b>	29	0	9	35.36	80
<b>Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale</b>	25	2	5	34.25	103
<b>Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media</b>	30	3	14	42.00	71
<b>Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e Forcës së Sigurisë</b>	22	2	6	21.58	69
<b>Të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione</b>	35	3	3	46.6	113
<b>Mbikëqyrja e Financave Publike</b>	26	1	1	48.8	78
<b>Mbikëqyrja e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë</b>	14	0	0	16.51	39

TABELA 1 Puna e Komisioneve Parlamentare gjatë vitit 2018

5 Ky Komision në cilësinë e komisionit funksional ka shqyrtuar 7 projektigje, dhe 56 projektligjeskomisioni përhershëm

6 Ky komision ka shqyrtuar 1 projektligjeskomision funksional dhe 73 projektligjetëtjerasikomisioni përhershëm

7 Ky komision ka shqyrtuar 21 projektligjeskomision funksional 21, dhe 42 projektligjetëtjerasikomisioni përhershëm.

8 Ky komision ka shqyrtuar 4 projektligjeskomision funksional (marrëveshjen der kombetare), dhe 72 projektligjetëtjerasikomisioni përhershëm

## 4. MBARËVAJTJA E SEANCAVE PARLAMENTARE

Mungesa e kuorumit ka karakterizuar punën e Kuvendit për vitin 2018, ku në pamundësi të vendimmarrjes shumica e seanceve plenare të mbajtura është dashur të shtyhen për ditë të tjera. Në rastet kur është siguruar kuorumi, shumë ligje nuk janë votuar, pasi që deputetët nuk kanë marrë pjesë në votim. Si rrjedhojë, shumë pika të papërfunduara të rendit të ditës nga seanca të ndryshme janë grumbulluar dhe vendosur në një seancë të vetme.

Bazuar në Rregulloren e Punës, Kuvendi i Kosovës javën plenare e fillon ditën e enjte për të vazhduar në ditën pasuese në rast të mospërfundimit të të gjithave pikave. Në të kaluarën, Kuvendi ka ndjekur këtë praktikë dhe është siguruar që rendi i ditës të mos jetë i tejngarkuar. Në këtë mënyrë, Kryesia e Kuvendit ka siguruar që seancat të kenë mbarëvajtje të rregullt dhe të jenë më efikase. Një organizim i tillë i mirëfilltë i punës sipas rregullores në fjalë nuk është përfillur në vitin 2018.

Koalicioni qeverisës është sfiduar vazhdimisht me mungesën e numrave. Lista Serbe, si partner i koalicionit qeverisës, në shumicën e rasteve ka bojkotuar Kuvendin, por edhe në rastet kur ka marrë pjesë ka qenë shumë pasive në seanca plenare. Bojkotimi i punës së Kuvendit nga ana e Listës Serbe si dhe mungesa e vetë deputetëve të koalicionit qeverisës ka ndikuar që shumica parlamentare të mos jetë e garantuar në Kuvend. Duke qenë në këtë situatë, opozita ka qenë faktori kyç në përmbushjen e agjendës legjislative gjatë këtij viti, përkundër bojkotimit të pjesëshëm të punës së Kuvendit. Subjektet opozitare, sidomos LDK dhe VV, në shumë raste kanë bojkotuar seancat plenare, përjashtimisht

në rastet kur është dashur të votohet për marrëveshje ndërkombëtare apo legjislacion me interes nacional.

Subjektet opozitare, sidomos gjatë sesionit vjeshtor, kanë bojkotuar në mënyrë të pjesshme Kuvendin, me mospjesëmarrjes në seanca dhe në votim. Ndonëse deputetët e VV-së dhe LDK-së nuk kanë marrur pjesë rregullisht në punimet e Kuvendit në seance plenare, megjithatë një gjë e tillë nuk ka ndodhur me punën e komisioneve parlamentare. Arsyet e mospjesëmarrjes së opozitës në punimet e Kuvendit kishin karakter politik, kryesisht duke dërguar mesazh se koalicioni qeverisës nuk ka shumicën e nevojshme për të kryer punët në Kuvend.

Gjuha joparlamentare dhe përdorimi i mjeteve jodemokratike kanë qenë prezente në seancat plenare edhe gjatë këtij viti. Punimet e seancës së jashtëzakonshme për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin në mes Kosovës dhe Malit të Zi janë përcjellë me hedhje të gazit lotsjellës nga Lëvizja Vetëvendosje, veprime këto të cilat e kishin karakterizuar gjithë Legjislaturën e V-të.

Në total janë mbajtur 42 seanca, prej të cilave 27 në sesionin pranveror dhe 15 në sesionin vjeshtor. Nga numri i përgjithshëm i seanceve, 23 ishin seance plenare, 16 të jashtëzakonshme dhe 3 solemne.



## 4.1 Seancat plenare

Karakteristikë e seancave plenare për vitin 2018 është fakti se pothuajse asnjë seancë plenare nuk ka përfunduar në ditën e fillimit të saj. Si rrjedhojë, seancat plenare kanë pasur vazhdimë në ditë të tjera në 43 raste. Problemi kryesor që ka penguar zhvillimin normal të seancave plenare ishte mungesa e kuorumit dhe pikat e shumëta të rendit të ditës. Si pasojë, Kuvendi ka mbyllur punimet për vitin 2018 pa arritur t'i përfundojë të gjitha seancat e filluara, përfshirë këtu çështje që kanë qenë në rend dite të seancave nga muaji shtator. Seancat plenare në përgjithësi kanë qenë të testër-ngarkuara me shumë pika të rendit të ditës, duke e bërë pothuajse të pamundur zhvillimin e rregullt të tyre. Në tërësi, janë zhvilluar gjithësej 23 seanca plenare, 16 në sesionin pranveror dhe 7 në sesionin vjeshtor.

Në mungesë të kuorumit dhe në pamundësi të votimit, deputetët kanë diskutuar sipërfaqësisht për shumicën e çështjeve të trajtuara në seanca plenare. Disa projektligje janë miratuar pa diskutime përmbajtësore në seancë, por edhe në rastet kur ka pasur diskutim, zakonisht në sallë kanë qenë të pranishëm një numër shumë i vogël i deputetëve.<sup>9</sup> Edhe shqyrtimi i çështjet tjera, si përzgjedhja e anëtarëve të bordeve të agjencive të pavarura, është karakterizuar me shtyerje e vonesa të shumta, gjë që ka ndikuar direkt në funksionalizimin e këtyre agjencive.

## 4.2 Seancat e jashtëzakonshme

Gjatë vitit 2018 janë mbajtur gjithësej 16 seanca të jashtëzakonshme. Në tri raste seancat e jashtëzakonshme nuk kanë përfunduar në ditën që kanë filluar, por janë vazhduar edhe në ditët në vijim. Shumica e seancave të jashtëzakonshme janë thirrur nga subjektet në opozitë, sidomos nga GP LDK dhe VV, dhe janë diskutuar çështje që përkonin me aktualitetin politik dhe social në vend, siç janë dialogu me Serbinë, deportimi i shtetasve turq, liberalizimi i vizave etj. Votimi i projektligjit për Rafitkimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror mes Kosovës

dhe Malit të Zi është realizuar përmes seancës së jashtëzakonshme. Seanca të jashtëzakonshme janë thirrur edhe për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me BE-në si dhe votimin e projekligjeve që derivojnë nga Agjenda për Reforma Evropiane. Në këto raste, thirrja e seancave të jashtëzakonshme është bërë në dakordim mes pozitës dhe opozitës, në mënyrë që të sigurohet kuorumi dhe votat e mjaftueshme për të kaluar projektligjet në fjalë.

## 4.3 Seancat solemne

Në vitin 2018 Kuvendi ka zhvilluar gjithësej tri seanca solemne, dhe të gjitha janë zhvilluar në muajin shkurt dhe mars. Përmes seancës solemne, deputetëve të Kuvendit të Kosovës u është adresuar Presidenti i Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor. Dy seancat tjera solemne janë thirrur për të shënuar 10 vjetorin e pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe 20 vjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

## 4.4 Debatet parlamentare

Mishi i prishur, ajri i ndotur, siguria e fëmijëve në internet, dialogu me Serbinë e mos-liberalizimi i vizave ishin disa nga arsyet e organizimit të një numri të madh të debateve parlamentare në Kuvend. Gjithësej 19 debate parlamentare janë realizuar, ku shumicën dërmuese të debateve parlamentare i kanë iniciuar subjektet në opozitë. Nga katër debate parlamentare janë inicuar nga GP VV dhe GP PSD, LDK dhe AAK kanë inicuar nga dy debate parlamentare, kurse PDK një debat parlamentar. Katër debate janë inicuar bashkarisht nga GP LDK dhe VV, kurse dy debate parlamentare, për mishin e prishur dhe personat e pagjetur, janë inicuar bashkarisht nga deputetët e pozitës dhe opozitës. Nga 19 debatet parlamentare të realizuara, numri më i madh i tyre janë inicuar për tema politike (8), pastaj për çështje sociale (5), çështje ekonomike (2), për arsim (1), mjedis (1), shëndetësi (1) dhe për drejtësi (1).

<sup>9</sup> Pwr shembull, Ligji pwr xxx

Shumica e debateve parlamentare janë karakterizuar me pjesëmarrje të vogël të deputetëve në seanca, dhe shpeshherë këto debate kanë përfunduar pa u arritur të miratohen rezolutat e propozuara nga këto debate ose rekomandimet e dala nga diskutimet. Nga të gjitha debatet e mbajtura, për vetëm gjashtë prej tyre rezolutat/ rekomandimet e propozuara kanë marrë miratim nga Kuvendi.<sup>10</sup> Subjektet politike parlamentare në përgjithësi kanë pasur qasje reaktive ndaj çështjeve të ngritura për debat parlamentar, e më pak tendenca për të parandaluar fenomene të caktuara.

## 4.5 Pjesëmarrja e deputetëve në seanca

Përveç bojkotit të pjesshëm të punës së Kuvendit nga grupet parlamentare të LDK dhe VV në sesionin vjeshtor të punës së Kuvendit, edhe pjesëmarrja e deputetëve të tjerë nuk ka qenë e rregullt. Puna e Kuvendit është karakterizuar me mungesë kuorumi dhe pamundësi vendimmarrjeje në shumicën e seancave plenare. Përgjatë vitit 2018, në total deputetët kanë realizuar 1671 mungesa, e që mesatarisht i bie 13.93 mungesa për një deputet.

Sa i përket mungesave të deputetëve sipas grupeve parlamentare, del se grupi parlamentar me më së shumti mungesa është grupi parlamentar i LDK-së, me gjithësej 436 mungesa, ndjekur nga VV me 257, Lista Serbe me 255, PDK me 196 dhe PSD me 186 mungesa. Grupi parlamentar me më së paku mungesa janë 6+ me 54 mungesa, NISMA me 76 mungesa dhe AAK me 132 mungesa.

Nëse kalkulohet mesatarja e mungesave për grup parlamentar, numrin më të madh e kanë deputetët e Lista Serbe, me mesatarisht 25.5 mungesa për deputet, ndjekur nga LDK me 17.4 mungesa dhe PSD me 15.5 mungesa. Duke përllogaritur mesataren e mungesave, deputetët e PDK-së kanë munguar më së paku në seanca, me 8.5 mungesa për deputet, pasuar nga 6+ me 9 mungesa dhe NISMA me 9.5 mungesa.


Deputetët që kanë munguar më së shumti në seanca të Kuvendit gjatë vitit 2018 janë: Ramiz Kelmeni (44), Gani Dreshaj e Srdjan Mitrovic (33), Faton Topalli e Teuta Rugova (31), Adem Hodza (30), Jelena Bontic e Saranda Bogujevci (29), Fisnik Ismajli (28) dhe Igor Simic (27).

Në anën tjetër, deputetët me më së paku mungesa të realizuara gjatë vitit 2018 janë: Bahrim Sabani (2), Fatmir Xhelili (3), Ahmet Isufi (4), Bilall Sherifi (4), Fadil Beka (4), Luljeta VeselajGutaj (4), Muharrem Nitaj (4), Andin Hoti (5), Evgjeni Thaçi Dragusha (5), Mexhide Topalli Mjaku (5) dhe Teuta Haxhiu (5).




Puna e Kuvendit është karakterizuar me mungesë kuorumi dhe pamundësi vendimmarrjeje në shumicën e seancave plenare. Përgjatë vitit 2018, në total deputetët kanë realizuar **1671 mungesa**, e që mesatarisht i bie **13.93 mungesa** për një deputet.

10 Debati për Ndotjen e ajrit, Debati për të drejtat e punëtorëve dhe adresimi i papunësisë në vend, Debati për Bashkimin e pikave doganore mes Kosovës dhe Shqipërisë, Debati për Kartonin e gjelbërt, Debati për Shtesat e fëmijëve dhe Debati për Personat e pagjetur.



**FIG. 4** Mungesat e deputetëve në seanca plenare: numri total dhe mesatarja sipas grupeve parlamentare






FIG. 5 Numri i seancave plenare dhe mungesat e deputetëve sipas muajve kalendarik



## 4.6 Lëvizjet e deputetëve nëpër Grupe Parlamentare

Gjatë vitit 2018 ka pasur lëvizje të deputetëve nëpër grupe parlamentare. Fillimisht, në fillim të vitit 2018 nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje janë larguar 13 deputetë, prej të cilëve 12 kanë formuar grupin e ri parlamentar, fillimisht të quajtur Grupi i Deputetëve të Pavarur, e pastaj grupi parlamentar i PSD-së. Kurse, deputetja Donika Kadaj-Bujupi nga Lëvizja Vetëvendosje ka kaluar në rradhët e Aleancës për Ardhëmrinë e Kosovës. Përveç Donika Kadaj-Bujupit, grupit parlamentar të AAK-së i është bashkuar edhe deputetja Emilija Redzepi në muajin maj.

“Përforcime” me deputet ka pasur edhe Nisma Socialdemokrate. Deputeti nga Partia Liberale Egjiptiane, Veton Berisha dhe ai nga Partisa e Ashkalinjve për Integrim, Etem Arifi, u janë bashkuar Nismës në muajin korrik.

Lëvizje ka pasur edhe në grupin parlamentar të LDK-së. Dy deputetët e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila dhe Ilir Deda, në shtator të vitit 2018 janë larguar nga grupi parlamentar i LDK-së dhe kanë vazhduar aktivitetin e tyre politik në Kuvend si deputet të pavarur (pa grup parlamentar).

Në vitin 2018, mandatin e deputetit e ka dorëzuar ish-deputeti i PDK-së, Nezir Çoçaj. Për shkak të mosfunksionalizimit të KQZ-së, ish-deputeti Çoçaj nuk është zëvendësuar ende. Si rrjedhojë, nga muaji shtator Kuvendi ka funksionuar me 119 deputet, kurse PDK-ja një deputet më pak në grup parlamentar.



Gjatë vitit 2018 ka pasur lëvizje të deputetëve nëpër grupe parlamentare. Fillimisht, në fillim të vitit 2018 nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje janë larguar 13 deputetë, prej të cilëve 12 kanë formuar grupin e ri parlamentar, fillimisht të quajtur Grupi i Deputetëve të Pavarur, e pastaj grupi parlamentar i PSD-së.

# 5. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

## 5.1 Pyetjet Parlamentare

Pyetjet parlamentare janë një nga mekanizmat përmes së cilave deputetët ushtrojnë mbikëqyrje ndaj ekzekutivit. Rregullorja e Kuvendit parashihet 60 minuta kohë për pyetje parlamentare për çdo seancë. Deputetët mund të parashtrorjnë deri në dy pyetje brenda një seance.

Ndonëse ka pasur numër të madh të pyetjeve parlamentare gjatë këtij viti, pjesa më e madhe e pyetjeve janë parashtruar

në sesionin pranveror gjegjësisht 248 pyetje parlamentare, ndërsa vetëm 27 pyetje parlamentare janë parashtruar në sesionin vjeshtor. Shumë prej pyetjeve që janë parashtruar në sesionin pranveror janë ri-lexuar në seancat që janë mbajtur në sesionin vjeshtor nga deputetët parashtrues, për shkak të mungesës së kabinetit qeveritar në punimet e Kuvendit. Gjatë vitit 2018 numri i përgjithshëm i pyetjeve parlamentare ka arritur në 275, 65% e të cilave kanë marrë përgjigje nga kabineti qeveritar.

− 96

Pyetje të cilat nuk kanë marrë përgjigje

FIG. 6

Ndarja e pyetjeve parlamentare sipas statusit të tyre


✓ 179

Pyetje që kanë marrë përgjigje



Pjesa dërrmuese e pyetjeve parlamentare të parashtruara vijnë nga deputetët e opozitës, prej të cilëve LVV-ja kryeson më numrin më të madh të pyetjeve me gjithsej 85 pyetje parlamentare prej të cilave përgjigje ka marrë në 51 prej tyre, e pasuar nga grupi parlamentar i LDK-se me 69 pyetje parlamentare ndërkaq përgjigje ka marrë në 37 prej tyre. Grupi parlamentar i PDK-së ka parashtruar 47 pyetje parlamenta-

re prej të cilave 37 kanë marrë përgjigje, PSD me 39 pyetje parlamentare ku prej tyre 32 kanë marrë përgjigje, NISMA dhe AAK me nga 13 pyetje parlamentare prej të cilave kanë marrë përgjigje 11 respektivisht 9 prej tyre dhe 6+ me një pyetje parlamentare e cila nuk ka marrë përgjigje. Ndërkaq grupi i deputetëve të pavarur kanë parashtruar 8 pyetje parlamentare të cilët kanë marrë përgjigje në vetëm 4 prej tyre.



**FIG. 7** Totali i pyetjeve parlamentare dhe numri i pyetjeve me përgjigje sipas grupit parlamentar



Numri më i madh i pyetjeve parlamentare (28%) u janë drejtuar ministrave nga radhët e AAK-së duke përfshirë këtu edhe kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinaj të cilët kanë dhënë përgjigje në 60% të pyetjeve të parashtruara. Me fare pak diferencë, me nga 27% të pyetjeve parlamentare u janë drejtuar ministrave të PDK-së dhe atyre të NISMA's të cilët i janë përgjigjur 65% respektivisht 69% të pyetjeve. Ndërkaq për ministrat nga AKR-ja janë parashtruar 14% e pyetjeve, prej të cilave ata kanë dhënë përgjigje në 71% të tyre, kurse për ministrat nga komu-

nitetet vetëm 4% e pyetjeve parlamentare, prej të cilave ata kanë dhënë përgjigje në 55%.

Nga të gjithë anëtarët e kabinetit qeveritar, më së shumti pyetje nga deputetët kanë marrë Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Shyqiri Bytyqi (NISMA) 40 pyetje nga numri i përgjithshëm i pyetjeve të parashtruara, pasuar nga Ministri i Shëndetësisë Uran Ismaili (PDK) me 39 pyetje, kryeministri Ramush Haradinaj (AAK) me 36 pyetje dhe Ministri i Infrastrukturës Pal Lekaj (AAK) me 34 pyetje.

MINISTRI/JA	SUBJEKTI POLITIK	PYETJE	PËRGJIGJE	NUK ËSHTË PËRGJIGJUR
Ableard Tahiri	PDK	8	6	2
Kujtim Gashi	PDK	15	14	1
Shyqiri Bytyqi	NISMA	40	26	14
Bedri Hamza	PDK	12	9	3
Valdrin Lluka	AKR	9	6	3
Dhurata Hoxha	PDK	1	0	1
Rrustem Berisha	AKK	7	5	2
Albena Reshitaj	AKR	11	9	2
Skender Reçica	NISMA	24	18	6
Nenad Rikallo	LS	4	1	3
Flamur Sefaj	AKR	4	4	0
Behgjet Pacolli	AKR	3	0	3
Pal Lekaj	AAK	34	15	19
Uran Ismaili	PDK	39	20	19
Ramush Haradinaj	AAK	36	26	10
Bajram Hasani	NISMA	4	2	2
Ivan Teodosijević	LS	0	0	0
Rasim Demiri	VAKAT	0	0	0
Besim Beqaj	PDK	0	0	0
Dardan Gashi	Pa Parti	0	0	0
Mahir Yagcilar	KDTP	6	5	1
Dalibor Jevtic	LS	1	0	1
Bejtush Gashi	AKR	10	7	3
Fatmir Limaj	NISMA	1	0	1
Endrit Shala	NISMA	5	5	0
Fatmir Matoshi	AKR	1	1	0

**TABELA 2** Pyetjet parlamentare ndaj Kabinetit Qeveritar





Shikuar në bazë të sektorëve ku janë parashtruar pyetjet shohim se pyetjet kanë qenë të koncentruara më shumë në tri sektorë, atij për Arsim ku janë parashtruar 39 pyetje parlamentare, Shëndetësisë (38) pyetje parlamentare dhe Infrastrukturë (29). Sektorët e tjerë ku janë parashtruar pyetje janë edhe Sociale (24), Financa dhe Drejtësi nga (16), Punë të Brendshme (15), Administratë, Mjedis dhe Siguri me 9 pyetje, Ekonomi, Bujqësi dhe

Blegtori nga 7 pyetje, në Tregti (6), Qeverisje Lokale dhe Sport me nga 4 pyetje, Shërbime Publike, Komunikacion, Aviacion dhe Planifikim Hapësinor me nga 3 pyetje, Energji dhe Drejta të Njeriut me nga 2 pyetje dhe Migrim/Kthim dhe Industri me nga 1 pyetje. Ndërka sektorët ku nuk është parashtruar asnjë pyetje parlamentare janë sektorët e Metalurgjisë, Pyltlarisë, Medias dhe Anti – korrupsionit.






FIG. 8 Pyetjet parlamentare të ndara sipas sektorëve



Për nga aspekti gjinor, shohim se numri i pyetjeve të parashtruar nga deputetët burra dhe deputetët gra nuk dallon shumë marrë parasysh edhe numrin më të madh të deputetëve burra që janë të përfaqësuar në Kuvend. Nga numri i përgjithshëm i pyetjeve të parashtruara gjatë këtij viti, deputetët burra kanë parashtruar 58% të tyre, ndërkaj deputetët gra i kanë parashtruar 42% të pyetjeve.

Vetëm 55 nga 120 deputetë sa janë në Kuvend kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të bërë pyetje parlamenta-


re dhe atë 14 nga LVV, 13 nga LDK, 8 nga PDK, 8 nga PSD, 5 nga NISMA, 3 nga AAK, dhe nga 1 pyetje nga 6+. Deputetët më të zëshëm me i pyetje parlamentare janë Bekim Haxhiu, PDK (18), I pasuar Besa Baftiu, PSD (17), Ismajl Kurteshi, LVV (15), Avdullah Hoti, LDK (13) ndërkaj deputetët me më së paku pyetje (1) janë deputetët: Elmi Reçica (PDK), Rexhep Selimi (LVV), Saranda Bogujevci (LVV), Frashër Krasniqi (PSD), Labinot Tahiri (Pa Grup), Slobodan Petrovic (Pa Grup) dhe Duda Balje (6+).

GRUPI PARLAMENTAR	DEPUTETI/JA	NUMRI I PYETJEVE
	Bekim Haxhiu	18
	Blerta Deliu	3
	Elmi Reçica	1
	Evgjeni Thaçi - Dragusha	3
	Ganimete Musliu	10
	Luljeta Veselaj – Gutaj	3
	Sala Berisha - Shala	2
	Nezir Qoqaj	7
	Armend Zemaj	4
	Avdullah Hoti	13
	Doruntina Maloku - Kastrati	2
	Driton Selmanaj	3
	Haxhi Avdyli	11
	Hykmete Bajrami	2
	Imet Rrahmani	6
	Lutfi Zharku	2
	Mirjeta Kalludra	6
	Naser Rugova	5
	Valentina Bunjaku - Rexhepi	9
	Vjosa Osmani - Sadriu	2
	Korab Sejdiu	4



<b>LVV</b>	Adem Mikullovc	4
	Albulena Haxhiu	11
	ArbërieNagavci	8
	Arbër Rexhaj	11
	Drita Millaku	6
	Ismajl Kurteshi	15
	Fitore Pacolli – Dalipi	3
	Rexhep Selimi	1
	Salih Zyba	6
	Sami Kurteshi	8
	Saranda Bogujevci	1
	ShemsiSyla	5
	Valon Ramadani	3
	XhelaSveçla	3
	AidaDërguti	2
	Besa Baftiu	17
	Dardan Sejdiu	2
<b>PSD</b>	Driton Qaushi	2
	Faton Topalli	3
	Frashër Krasniqi	1
	SalihSalihu	2
	Shqipe Pantina	10
	Bitall Sherifi	2
	Enver Hoti	2
	Haxhi Shala	2
	Zafir Berisha	5
	Albulena Balaj - Halimaj	2
<b>NISMA</b>	RasimSelmanaj	3
	Time Kadrijaj	5
	Teuta Haxhiu	5
<b>AAK</b>	Labinot Tahiri	1
	SlobodanPetrovic	1
	Mimoza Kusari - Lila	6
<b>DP</b>		
<b>6+</b>	Duda Balje	1

**TABELA 3** Deputetët dhe numri i pyetjeve parlamentare të parashtruara nga ta



## 5.2 Raportimi i ministrave në Komisione Parlamentare

Në kuadër të aktiviteteve mbikëqyrëse, Komisionet Parlamentare gjatë vitit 2018 kanë ftuar për raportim 81 herë anëtarët e kabinetit qeveritar. Në kuadër të raportimeve të ministrave janë përfshirë edhe prezantimet e projektligjeve nga ana e ministrave në Komisione që janë sponsorizuar nga ministritë e linjës. Numri i madh i raportimeve të ministrave në komisione këtë vit ka ardhur edhe si rezultat i mbikëqyrjes më të madhe ndaj përmeshjes së obligimeve të agjendës evropiane nga ana e Qeverisë.

Ministrat që janë ftuar më së shumti raportime në komisione parlamentare gjatë vitit 2018 janë ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Shyqiri Bytyqi me 11 raportime, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Skendër Reçica me 9 raportime dhe ministri i Ministrisë së Financave z. Bedri Hamza me 7 raportime.

Ndërkaq sa i përket Komisioneve që kanë ftuar më së shumti ministra në raportim prinë Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal i cili kishte ftuar për raportim dhjetë herë ministrat të katër ministrive të linjës, tri herë ishte ftuar në raportim ministri i Zhvillim Ekonomik, z. Valdrin Lluka, nga dy herë ishin ftuar ministrat si në vijim: ai për Infrastrukturë z. Pal Lekaj, për Zhvillim Rajonal z. Rasim Demiri dhe për ai për Tregti dhe Industri z. Endrit Shala. Ndërkaq një herë ishte ftuar në raportim tanimë ish – ministri për Tregti dhe Industri Bajram Hasani. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi është komisioni tjetër me më së shumti raportime të ministrave, i cili ka ftuar ministritë e linjës në raportim për çështje të caktuara. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Shyqiri Bytyqi ka marrë pjesë 7 herë në raportim në komision, ndërsa ministri i Inovacioneve dhe Ndërmarrësisë z. Besim Beqaj dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim Gashi kanë raportuar nga një herë në komision. Edhe Komisioni për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione ka qenë mjaft aktiv në këtë drejtim. Për vitin 2018, komisioni kishte ftuar tetë herë në raportim ministrat e pesë ministrive. Komisioni ka ftuar dy herë në raportim ministrin e Ministrisë

së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Shyqiri Bytyqi, tri herë ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Skendër Reçica, dhe nga një herë ishin ftuar për raportim ministri i Administratës Publike z. Mahir Yagcilar, ministri i Shëndetësisë z. Uran Ismajli dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka. Ndërkaq nga ftesat që u janë dërguar ministrave për raportim nga komisionet përkatëse, nga një herë nuk u janë përgjigjur pozitivisht ftesave të komisioneve, ministri i Punëve të Jashtme z. Behgjet Pacolli, ministri i Punëve të Brendshme, ai për Financa z. Bedri Hamza, i Bujqësisë z. Nenad Rikallo. Për Komunitete dhe Kthim z. Dalibor Jevtic dhe ai i Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka, por që asnjë prej tyre nuk kanë përgjigjur ftesës së komisionit.

## 5.3 Interpelancat

Interpelanca si një prej instrumenteve të ushtrimit të rolit mbikëqyrës nga Kuvendit është shfrytëzuar në masë të madhe nga opozita. Kërkesa për mbajtjen e të gjitha interpelancave që janë mbajtur gjatë vitit 2018, janë iniciuar në sesioni pranveror të punës së Kuvendit.

Janë gjithsej 12 interpelanca të thirrura gjatë këtij viti të iniciuara nga opozita për çështje të ndryshme e të cilat janë rezultuar edhe me miratim të rezolutave dhe rekomandimeve për çështjet për çka edhe janë iniciuar ato. 11 interpelanca janë iniciuar nga grupet parlamentare të LDK-së dhe LVV (4 secila) dhe 3 të përbashkëta. Ndërkaq një interpelancë është thirrur nga grupi parlamentar i PSD-së. Nga këto 12 interpelanca, 10 prej tyre i janë drejtuar Kryeministrit Haradinaj, një interpelancë i është drejtuar ministrit të Shëndetësisë Uran Ismajli dhe një interpelancë i është drejtuar Ministres së Integritimit Evropian Dhurata Hoxha. Për secilën interpelancë të thirrur, anëtarët e kabinetit qeveritar për të cilët janë thirrur këto interpelanca kanë treguar gatishmëri që të marrin pjesë.

Mungesa e kuorumit ka ndikuar edhe në mbarëvajtjen e interpelancave të mbajtura, pasi që votimi i shumicës së rezolutave dhe rekomandimeve të nxjerra është tejzgatur e në disa raste edhe nuk kanë marrë përkrahjen e deputetëve të shumicës parlamentare.




FIG. 9 Numri i interpelancave gjatë vitit 2018 të inicuar nga grupet parlamentare

## 5.4 Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura

Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura vazhdon të jetë problematike për organin më të lartë legjislativ. Shqyrtimi i raporteve vjetore të punës së 34 institucioneve të pavarura që i raportojnë direkt Kuvendit është mekanizmi i vetëm me të cilën Kuvendi mban nën mbikëqyrje dhe llogaridhënese këto institucione, sado që një mekanizëm i tillë është i pamjaftueshëm për të pasur një mbikëqyrje efektive.

Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuara 26 raporte vjetore të këtyre institucioneve të pavarura për vitin 2018. Nga gjithsej 14 komisione, 9 prej tyre kanë shqyrtuar raportet vjetore të institucioneve të pavarura. Ndërsa Komisioni për Buxhet dhe Financa përveç shqyrtimit të raporteve vjetore të linjës ka shqyrtuar në aspektin financiar të gjitha raportet tjera të shqyrtuara paraprakisht nga komisionet funksionale. Poashtu Komisioni për mbikëqyrje të financave publike ka shqyrtuar 28 raporte të auditimi të PVF – ve të institucioneve të pavarura, ministrive dhe ndërmarreve publike.

Në rastet kur Kuvendi nuk arrin t'i miratojë raportet e institucioneve të pavarura, ato nuk sanksionohen për shkak se legjislacioni i aplikueshëm nuk parasheh ndonjë procedurë apo masë ndëshkimore për rastet e tilla. Kuvendi ndonëse ka miratuar edhe raportet dhe rekomandimet e nxjerra nga Zyra Kombëtare e Auditimit për institucionet e pavarura nuk ka ushtruar kontroll të duhur mbi institucionet përkatëse për të parë nëse këto rekomandime të ZKM-së janë zbatuar. Për shkak të mbikëqyrjes joefektive nga ana e Kuvendit, rekomandimet e ZKM-së vazhdojnë të përsëriten nga vit në vit.

Një sfidë tjetër në rolin e Kuvendit në raport me institucionet e pavarura janë vonesat në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të këtyre institucioneve dhe politizimi i procesit të emërimit të anëtarëve të bordeve.

Gjatë këtij viti, Kuvendi ka zgjedhur gjithsej 33 anëtarë të bordeve të institucioneve të pavarura. Përveç anëtarëve të bordeve, Kuvendi gjithashtu këtë vit ka zgjedhur edhe dre-

jtorin e Agjencisë së Menaxhimit të Komplekseve Memoriale, për të cilin Kuvendi kishte përsëritur konkursin pasiqë asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk kishte marrë votat e mjaftueshme. Kuvendi gjithashtu ka zgjedhur edhe kryetar-in e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik si dhe pesë zëvendësit e Avokatit të Popullit, e konkursi për këta të fundit ishte shpallur në fillim të vitit 2017.

Zvarritje në procesin e përzgjedhjes ka pasur edhe në rastin e emërimit të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese, e cila për më shumë se tre muaj ishte jo funksionale si pasojë e vonesave në përzgjedhjen e tyre nga ana e Kuvendit dhe dekretimin nga Presidenti i vendit. Si rezultat i këtyre vonesave, institucioneve të caktuara kushtetuese sic është KQZ-ja i'u është pamundësuar funksionimi kushtetues duke qenë se përbërja e re e këtij institucioni ende nuk është dekretuar. Për shkak të mos konstituimit të KQZ-së, Kuvendi aktualisht ka mbetur me një deputet më pak në mungesë të zëvendësimit të deputetit Nezir Çoçaj.

Për mungesë kuorumi, Kuvendi i Kosovës që nga muaji tetor ka dështuar që t'i përzgjedhë edhe shtatë anëtarë të Këshillit të Kosovës për trashëgimi Kulturorë, kryesuesin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si dhe shkarkimin e z. Shqiprim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare.

## 5.5 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Aktualisht numri i përgjithshëm i ligjeve që janë në fuqi është 459. Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2018 bazuar edhe në agjendën legjislativë të stërngarkuar që ka pasur për këtë vit nuk ka arritur që të përmbyshë planin edhe për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në fuqi ndonëse sipas Rregullores së Punës e ka për detyrë që të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve.

Në bazë të planifikimeve vjetore të Kuvendit, prioritet vazhdon të jetë shqyrtim i projektligjeve. Koncentrimi i Kuvendit vetëm në procesin ligjbërës, pavarësisht që shumë prej lig-



jeve nuk gjejnë zbatim në praktikë, ka vënë në hije aktivitetet mbikëqyrëse të këtij institucioni karshi zbatimit të ligjeve të miratuara. Bazuar në plan - programin e punës së Kuvendit për vitin 2018, ishte paraparë monitorimin e zbatimit të 25 ligjeve nga 12 komisione parlamentare.

Nga 12 komisione parlamentare që kanë paraparë mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve, vetëm një prej tyre, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka përfunduar raportin për monitorim të zbatimit të një ligji të planifikuar

për monitorim dhe i njëjti është miratuar në seancë plenare. Tri komisione të tjera, Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione kanë përfunduar raportet e tri ligjeve të monitoruara por që të njëjta nuk janë proceduar për miratim në seancë gjatë periudhës raportuese. Ndërkaq për 21 ligje të tjera të planifikuara për monitorim nga komisionet përgjegjëse për t'i monitoruar ato ligje nuk kanë zhvilluar asnjë aktivitet mbikëqyrës për to.

25

LIGJE TË PLANIFIKUARA



3

LIGJE NË  
PROCEDURË



1

LIGJ I  
MBIKËQYRUR



**FIG. 10** Monitorimi i zbatimit të ligjeve nga Kuvendi i Kosovës



## 6. SHPENZIMET E KUVENDIT

Kuvendi i Kosovës është institucioni që e shqyrton dhe jep miratimin final për të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, dhe më pastaj i mbikëqyrë shpenzimet e parasë publike andaj do të duhej të shërbente si obligim për këtë institucion që të jetë model sa i takon transparencës financiare.

Deri në përfundim të vitit 2018, Kuvendi kishte miratuar vetëm raportin për gjashtë mujorin e parë të vitit, ndërkaq në fillim të vitit 2019 Kuvendi ka miratuar edhe raportin nëntë mujor. Përveç mos publikimit në kohë të raporteve financiare nga ana e Kuvendit, edhe shpenzimet e publikuar deri më tani nuk janë të paraqitura në mënyrë më të detajuar gjë që kufizon në vlerësimin e menaxhimit të buxhetit nga Kuvendi.

Për vitin 2018, buxheti i ndarë për Kuvendin e Kosovës ka qenë 11,440,534.00 €. Për kategorinë Paga dhe mëditje kanë qenë të parapara 7,261,534.00 € ose shprehur në përqindje 63.47% e buxhetit total. Për kategoritë e tjera si ajo për Mallra dhe Shërbime janë planifikuar 2,312,000.00 € (20.21%), për shpenzimet komunale janë planifikuar 241,000.00 € (2.11%), për Shpenzimet kapitale janë planifikuar një buxhet prej 1,486,000.00 € (12.99%) dhe në kategorinë për Subvencione dhe Transfere janë planifikuar gjithsej 140,000.00 € (1.22%) të buxhetit.

Në bazë të raportit nëntë mujor për vitin 2018, Kuvendi i Kosovës ka shpenzuar 6,289,034.56 € nga buxheti total për vitin 2018. Për periudhën nëntëmujore të vitit 2018, buxhetit të shtetit i kanë kushtuar 5,069,924.94 € vetëm për paga dhe mëditje të deputetëve që nënkupton që 81% e buxhetit total të shpenzuar nga Kuvendi për këtë periudhë është shpenzuar në këtë kategori. Krahas shpenzimeve të mëdha për kategorinë paga dhe mëditje, vetëm 20% e buxhetit të përgjithshëm është shpenzuar në katër kate-

goritë e tjera. Në kategorinë për Mallra dhe Shërbime për periudhën raportues janë shpenzuar 956,685.29 € apo në përqindje 15% e buxhetit total të shpenzuar. Ndërkaq 4% i të gjithë buxhetit të shpenzuar për këtë periudhë kohore është shpenzuar në kategoritë si në vijim: për Shpenzimet Komunale ku janë shpenzuar 138,959.09€, për Shpenzimet Kapitale 23,220.00 €, dhe për Subvencione dhe Transfere 100,245.24€.



Deri në përfundim të vitit 2018, Kuvendi kishte miratuar vetëm raportin për gjashtë mujorin e parë të vitit, ndërkaq në fillim të vitit 2019 Kuvendi ka miratuar edhe raportin nëntë mujor.





14

VIZITA  
NË KONTINENTIN  
E AMERIKËS

## 7. UDHËTIMET E DEPUTETËTVE JASHTË VENDIT

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë qenë mjaft aktiv sa i përket udhëtimeve jashtë vendit në vitin 2018. Për periudhën janar – shtator në bazë të raporteve të publikuara, deputetët kanë realizuar 300 udhëtime jashtë vendit të cilat i kanë kushtuar buxhetit në total 239,039.65 €. Në bazë të këtij raporti, del se nga 120 deputetët, 87 prej tyre kanë realizuar udhëtime jashtë vendit përdherisa 33 të tjerë për këtë periudhë kohore nuk kanë udhëtuar asnjëherë jashtë vendit. Në raportet e publikuara mungojnë të dhënat lidhur me arsyet e vizitave të deputetëve jashtë vendit, shpenzimet për biletat për secilin deputetë që ka realizuar udhëtim dhe datat e qëndrimit të deputetëve nëpër vendet e vizituara.

Numri më i madh i këtyre vizitave janë në vendet e kontinentit të Evropës (285), me përjashtim të 14 vizitave në kontinentin e Amerikës dhe- një vizitë në kontinentin e Azisë. Kurse vendet më të vizituara nga deputetët janë Shqipëria me 51 vizita, pastaj Franca me 40 dhe Maqedonia me 35 vizita.




FIG. 11 Numri i udhëtimeve zyrtare të deputetëve sipas kontinenteve



Grupi parlamentar me më së shumti udhëtime jashtë vendit është grupi parlamentar i PDK-së me gjithsej 77 udhëtime jashtë vendit të realizuara vetëm gjatë periudhës janar – shtator 2018. Nga 23 deputetë sa ka gjithsej grupi parlamentar i PDK-së, 19 prej tyre kanë udhëtuar të paktën njëherë gjatë kësaj periudhe. Destinacioni më i frekuentuar i deputetëve të PDK-së ka qenë Shqipëria dhe Maqedonia me nga 14 udhëtime të realizuar në secili prej këtyre shteteve.

Grupi i dytë parlamentar me më së shumti udhëtime në bazë të raporteve të disponueshme është grupi parlamentar i LDK – së të cilët kanë realizuar gjithsej 64 udhëtime jashtëvendit. Nga numri i përgjithshëm i deputetëve që ka ky grup parlamentar (25), 20 prej tyre kanë realizuar udhëtime jashtë vendit. Shqipëria është vendi më vizituar edhe për grupin parlamentar të LDK-së me gjithsej 14 udhëtime nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve të realizuara nga ky grup.

Në bazë të raporteve të shpenzimeve të disponueshme, del që grupi i tretë parlamentar me më së shumti udhëtime është 6+, deputetët e së cilit grup kanë realizuar në total 29 udhëtime jashtë vendit. Të gjithëdeputetët që janë pjesë e këtij grupi parlamentar (6) kanë realizuar të paktën një udhëtim jashtë vendit. Vendi ku janë realizuar më së shumti udhëtime të grupit parlamentar të 6+ është Turqia me gjithsej 10 udhëtime nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve të realizuara nga ky grup.

AAK – ja është grupi i katërt parlamentar që ka realizuar më së shumti udhëtime zyrtare me gjithsej 28 udhëtime të realizuara nga deputetët e këtij grupi. Nëntë nga 12 deputetë sa ka nëpërbërje ky grup parlamentar 9 prej tyre kanë udhëtuar të paktën njëherë gjatë periudhës janar – shtator 2018. Ngjashëm sikurse për dy grupet e para parlamentare sa i përket udhëtimeve, edhe AAK numrin më të madh të vizitave e ka realizuar në Shqipëri me gjithsej 8 udhëtime atje.

Me numër të njëjtë të udhëtimeve të realizuara sikurse AAK-ja është edhe grupi parlamentar i LVV –së me gjithsej 28 udhëtime të realizuara jashtë vendit. Janë 10 deputetët të këtij grupi parlamentar nga 19 deputetë sa janë gjithsej që kanë realizuar udhëtime jashtë vendit. Shqipëria është vendi

me më së shumti udhëtime nga ky grup parlamentar me gjithsej 5 udhëtime nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve të realizuara.

Grupi tjetër me më së shumti udhëtime në nëntë mujorin e vitit 2018, është grupi parlamentar i PSD – së të cilët kanë realizuar në total 25 udhëtime jashtë vendit. Shtatë deputetë nga 12 sa janë gjithsej pjesë të këtij grupi parlamentar kanë realizuar të paktën një udhëtim. Franca është shteti më i vizituar nga grupi parlamentar i PSD-së me gjithsej 6 udhëtime.

Grupi parlamentar i NISMA –së ka realizuar gjithsej 22 udhëtime jashtë vendit nga 7 deputetë të këtij grupi nga 8 deputetë që janë pjesë e këtij grupi parlamentar. Janë dy shtete që janë vizituar më së shumti nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve të realizuara nga ky grup parlamentar si në vijim: Shqipëri (3 dhe Gjermani (3).

Lista Serbe është grupi parlamentar me më së paku udhëtime të realizuara bazuar në raportet financiare që janë publike, me gjithsej 11 udhëtime. Nga 10 deputetë që janë pjesë e këtij grupi parlamentar, vetëm 5 prej tyre kanë realizuar udhëtime jashtë vendit. Dy shtetet ku kanë udhëtuar më së shumti ky grup parlamentar është i Austrisë (2) dhe Francës (2).

Ndërkaq katër nga pesë deputetët që janë pa grup parlamentar ( Mimoza Kusari – Lila, Ilir Deda, Islam Pacolli, Slobdan Petrovic) kanë realizuar gjithsej 16 udhëtime jashtë vendit. Prej këtyre udhëtimeve, destinacionimë i frekuentuar është Gjermania me 5 udhëtime.


Pesëmbëdhjetë deputetët me numrin më të madh të udhëtimeve në bazë të raporteve financiare janë Kadri Veseli, PDK (11), Armend Zemaj, LDK (10), Blerta Deliu – Kodra, PDK (10), Fikrim Damka, 6+ (9), Aida Dërguti, PSD (9), Xhavit Haliti, PDK (8), Mufera Sinik, 6+ (8), Teuta Haxhiu, AAK (8), Vjosa Osmani – Sadriu, LDK (6), Glauk Konjufca, LVV (6), Mimoza Kusari – Lila, Pa Grup (6), Driton Selmanaj, LDK (6), Nait Hasani, PDK (6), Visar Ymeri, PSD (6) dhe Slobodan Petrovic, Pa Grup (6).





**TOP DEPUTETËT ME NUMRIN MË TË MADH TË UDHËTIMEVE NË BAZË TË RAPORTEVE FINANCIARE JANË**

- 1 Kadri Veseli, PDK (11),
- 2 Armend Zemaj, LDK (10),
- 3 Blerta Deliu – Kodra, PDK (10),
- 4 Fikrim Damka, 6+ (9),
- 5 Aida Dërguti, PSD (9),
- 6 Xhavit Haliti, PDK (8),
- 7 Mufera Sinik, 6+ (8),
- 8 Teuta Haxhiu, AAK (8)



**FIG. 12** Udhëtimet e deputetëve sipas Grupit Parlamentar





## 8. REKOMANDIMET

### INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS NË BAZË TË GJETJEVE TË EVIDENTUARA GJATË MONITORIMIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOSOVËS PËR VITIN 2018 KA DHËNË REKOMANDIMET SI NË VIJIM:

- 1** Si institucioni më i lartë përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e shpenzimit të buxhetit të shtetit, Kuvendi i Kosovës duhet të jetë shembull për të gjitha institucionet tjera sa i përket transparencës financiare. Raportet e shpenzimeve duhet të publikohen me kohë dhe të jenë të detajuara, të përmbajnë informata mbi qëllimet e vizitave të deputetëve jashtë vendit. Kuvendi i Kosovës do të duhej të publikonte vendimet e Kryesisë së Kuvendit për secilin udhëtim të aprovuar të deputetëve.
- 2** Edhe pse një numër i madh i ligjeve janë miratuar këtë vit, shqyrtimi i tyre nuk i është nënshtruar debatit të mirëfilltë publik, duke komprometuar kështu parimin e gjithpërfshirjes dhe të konsultimit me palët e interesit. Kjo mangësi e theksuar vazhdimisht edhe në Raportet për Kosovën të Komisionit Evropian, duhet të adresohet me seriozitet në mënyrë që qytetarëve dhe grupeve të interesit t'u mundësohet dhënia e kontributit dhe pronësia në procesin ligjvënës dhe rrjedhimisht të garantohet një implementim më i mirë i tyre në praktikë.
- 3** Në të kaluarën, dështimi i Qeverisë për të sjellë projektligje në Kuvend i është faturuar Kuvendit si dështim për mospërmblidhjen e agjendës legjislative. Për të shmanhur këtë skenar, Kuvendi do të duhet të bashkërendonte me Qeverinë hartimin e agjendës legjislative, në mënyrë që ajo të mos jetë shumë ambicioze dhe përtej kapaciteteve të të dyja institucioneve.
- 4** Krahas funksionit të tij ligjvënës, Kuvendi do të duhej që proporcionalisht t'i kushtojë rëndësi mbikëqyrjes efektive të zbatimit të ligjeve, sidomos kur ngecjet e vendit në përgjithësi i atribuohen moszbatimit të ligjeve. Korniza ligjore në Kosovë vetëm sa është drejt plotësimit me ligjet kryesore dhe fokusi për të ardhmen duhet të jetë në aktivitetet e shtuara mbikëqyrëse. Kuvendi duhet të ketë në fokus monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe mbikëqyrjen e qeverisë në mënyrë sistematike.
- 5** Kuvendi duhet ta rikthejë praktikën e mbajtjes së seancave në ditën e enjte eventualisht në të premten, ashtu siç parashihet me Rregulloren e Punës, në mënyrë që t'i jepet hapësirë komisioneve parlamentare që mbledhjet e tyre t'i mbajnë ditëve të tjera. Në këtë mënyrë do të zvogëlohej mundësia e dështimit qoftë të seancave ose të mbledhjeve të komisioneve dhe të grumbullimit të çështjeve që duhet të shqyrtohen.
- 6** Mbajtja e seancave plenare deri në orët e vona të natës ulë transparencën e Kuvendit karshi publikut dhe ua pamundëson qytetarëve që të përcjellin shqyrtimin dhe votimin e projektligjeve në shqyrtim. Andaj, Kuvendi i Kosovës duhet ta ndërpres këtë praktikë jo të mirë parlamentare, dhe të organizojë punimet në atë mënyrë që deputetët të jenë efikas në punën e tyre dhe qytetarët të kenë mundësinë të përcjellin punimet e Kuvendit.
- 7** Mungesat e deputetëve do të duhej të rregulloheshin përmes Rregullores së re të Punës së Kuvendit. Rregullorja aktuale nuk parashihet ndonjë masë ndëshkuese për deputetët të cilët nuk marrin pjesë në punimet e Kuvendit, dhe u ofron mundësinë e mospjesëmarrjes në punë për gjashtë muaj me radhë. Kjo zbrastëti ligjore është shfrytëzuar nga deputetët dhe ka ndikuar direkt në mundësimin e bojkotimit të punës së Kuvendit.



## 9. SHTOJCAT

### SHTOJCA 1: Analizë e punës së Komisioneve Parlamentare

#### Komisioni për Buxhet dhe Financa

Gjatë vitit 2018 Komisioni për Buxhet dhe Financa ka realizuar gjithsej 29 takime, prej të cilave 28 ishin mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik. Në planin e punës për vitin 2018, komisioni ka paraparë shqyrtimin e 12 projektligjeve, prej të cilëve i ka shqyrtuar shtatë, kurse pesë të tjerë nuk ka arritur t'i shqyrtojë fare. Në përgjithësi, përgjatë vitit komisioni ka shqyrtuar gjithsej 63 projektligje, duke përfshirë edhe vlerësimin për implikime financiare për projektligjet nga komisionet funksionale.

Në planin e punës, komisioni ka paraparë edhe monitorimin e zbatimit të dy ligjeve: Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare dhe Ligjin për Fondet Pensionale të Republikës së Kosovës. Nga monitorimi i punës së komisionit, vërehet se ky komision ka monitoruar vetëm një ligj, atë për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare. Megjithatë, përkundër përfundimit të procesit të monitorimit të këtij ligji, raporti i monitorimit ende nuk është votuar nga deputetët në seancë plenare.

Komisioni ka shqyrtuar raportet vjetore të katër agjencive të pavarura, ndaj të cilave kryen edhe mbikëqyrje, si në vijim: Organit Shqyrtues të Prokurimit, Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, Fondit të Kursimeve Personale si dhe Bankës Qendrore të Kosovës. Ky komision ka shqyrtuar edhe raportet financiare të 23 agjencive tjera të pavarura. Për më tepër, ky komision ka shqyrtuar edhe raportet e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës.

Sa i përket raportimit nga ekzekutivi, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka ftuar në raportim gjashtë herë ministrin e Financave, Bedri Hamza, i cili i është përgjigjur pozitivisht ftësive, si dhe vartësit e tij nga Ministria e Financave. Asnjë ministër tjetër nuk ka qenë i ftuar në raportim në këtë komision gjatë vitit 2018.

#### Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka realizuar gjithsej 24 mbledhje, dhe asnjë dëgjim publik. Sipas planit të punës, komisioni nuk kishte parashikuar trajtimin e asnjë ligji specifik që bie në fushëveprimtarinë e tij. Megjithatë, ky komision ka iniciuar një nismë legjislative, atë për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës. Në ndërkohë, në cilësinë e komisionit të përhershëm, ka shqyrtuar 74 projektligje nga komisionet funksionale.

Në bazë të planit të punës, komisioni kishte paraparë monitorimin e dy projektligjeve: Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Përkundër planifikimit dhe formimit të grupeve punuese, monitorimi nuk është kryer për asnjë nga ligjet e parapara. Komisioni madje kishte planifikuar edhe organizimin e dëgjimeve publike për të dy ligjet e parapara për monitorim, por as ato nuk janë realizuar për shkak të mosrealizimit të monitorimit të zbatimit të ligjeve të parapara. Komisioni

nuk ka përmbushur edhe disa pika tjera të planifikuara me planin e punës. Komisioni kishte planifikuar realizimin e vizitave të shumta në terren në të gjitha qytetet e mëdha të Kosovës, mirëpo ka realizuar vetëm dy sosh, respektivisht në Graçanicë dhe nëPejë.

Komisioni ka ngecur edhe në përmbushjen e planin të punës sa i përket raportimit të ministrave në komision. Ndonëse me plan të punës ishin planifikuar raportimet e shtatë ministrave, vetëm tre prej tyre e kanë bërë një gjë të tillë: Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministri i Arsimit dhe Ministri i Punëve të Brendshme. Është me rëndësi të përmendet fakti se përkundër ftesës nga ana e deputetëve, asnjëherë nuk ka raportuar në komision Ministri për Komunitete dhe Kthim, ministri kjo e cila mbikëqyrret nga ana e këtij komisioni.

## **Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit**

Gjatë vitit 2018, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka realizuar gjithsej 43 mbledhje, 38 prej tyre kanë qenë mbledhje të rregullta dhe 5 dëgjime publike. Komisioni ka shqyrtuar 21 projektligje në cilësinë e komisionit të përhershëm, kurse ka shqyrtuar edhe raportet e komisioneve funksionale për 42 ligje të tjera. Në tërësi, gjatë vitit 2018, komisioni ka shqyrtuar 63 projektligje. Përveç projektligjeve, komisioni ka qenë bartës i procesit për shqyrtimin e Rregullores së re të Punës së Kuvendit. Ky komisionin e ka trajtuar Rregulloren e Punës së Kuvendit qoftë përmes grupit punues të formuar ekskluzivisht për trajtimin e Rregullores, apo edhe përmes mbledhjeve të rregullta të komisionit.

Komisioni për Legjislacion në planin e punës për vitin 2018 kishte planifikuar iniciimin e dy nismave legjislative, asaj për

hartimin e Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit si dhe Projektligjit për Familjen. Megjithatë, komisioni ka arritur ta përfundojë vetëm nismën ligjore për Projektligjin për Familjen. Gjithashtu, komisioni nuk ka arritur ta përmbushë planin e punës edhe në aspektin e monitorimit të zbatimi të ligjeve. Në bazë të planit të punës, komisioni ka paraparë monitorimin e zbatimit të tri ligjeve: Ligjit për Kundërvajtje, Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Përkundër formimit të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve në muajin shkurt, komisioni nuk ka proceduar me zhvillimin e procedurave të monitorimit përgjatë periudhës raportuese.

Komisioni në planin e punës ka planifikuar edhe shqyrtimin e raporteve vjetore për agjencitë e pavarura, duke mos specifikuar se cilat agjenci ose sa raporte do të shqyrtohen. Megjithatë, gjatë vitit 2018, komisioni ka shqyrtuar katër raporte vjetore të punës, përkatësisht raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Akademisë së Drejtësisë. Të gjitha këto agjenci të pavarura janë në mbikëqyrje të komisionit. Megjithatë, ky komision nuk i ka shqyrtuar raportet vjetore edhe të shtatë agjencive tjera të pavarura të cilat i ka nën mbikëqyrje.

Gjatë vitit 2018, në komision ka raportuar pesë herë Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri. Në muajin nëntor, komisioni ka realizuar një takim të përbashkët me Kryeministrin e Kosovës, Ministrin e Drejtësisë dhe Ministren e Integritimit Evropian, për të diskutuar për pakon e ligjeve të cilat potencialisht do të ndikonin në procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën. Në përgjithësi, deputetët e këtij komisioni kanë qenë të përkushtuar në shqyrtimin e projektligjeve, duke ofruar sugjerime dhe duke komentuar nene dhe pjesë të caktuara të ligjeve.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka realizuar numrin më të madh të dëgjimeve publike krahasuar me komisionet tjera të Kuvendit. Dëgjimet publike janë realizuar kryesisht për të diskutuar për projektligje të cilat kanë qenë në shqyrtim e sipër nga komisioni.

## Komisioni për Integritet Evropiane

Komisioni për Integritet Evropiane, si komision i përherëshëm, ka realizuar gjithsej 22 mbledhje dhe asnjë dëgjim publik. Ky komision është ndër komisionet që ka zhvilluar numrin më të vogël të mbledhjeve përgjatë vitit 2018. Si komision funksional, në planin e punës nuk ka planifikuar të shqyrtojë asnjë projektligj specifik, mirëpo ka shqyrtuar arkatë projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare<sup>11</sup>, si dhe projektligjet e komisioneve funksionale dhe përputhjen e tyre me legjislacionin e BE-së. Në tërësi, ky komision ka shqyrtuar gjithsej 72 projektligje nga komisionet funksionale.

Sipas planin e punës për vitin 2018, komisioni ka paraparë monitorimin e zbatimit të Ligjit për Përgjimin e Telekomunikimeve, por kjo pikë e planit nuk është përbushur. Poashtu, përmes planit të punës, komisioni kishte planifikuar që të ftojë në raportim një numër të konsiderueshëm të ministrave, mirëpo ky planifikim nuk është përbushur në tërësi. Në këtë komision kanë raportuar pesë ministra në gjithsej nëntë raste, duke përfshirë pesë raportime të Ministres së Integritet Evropian, Dhurata Hoxha, si dhe nga një herë raportuan: Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqyri Bytyqi, ish-Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, si dhe Ministri i Administratës Publike, Mahir Yağcılar. Sipas planit të punës, komisioni kishte planifikuar që në raportim të ftohen edhe Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Financave, Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik, por që një gjë e tillë nuk është realizuar. Të gjitha raportimet e ministrave janë realizuar në sesionin pranveror të punës së Kuvendit.

Komisioni përgjatë vitit ka diskutuar për çështje konkrete që lidhen me rrugëtimin e Kosovës drejt integritet evropian,

përfshirë këtu zbatimin e MSA-së, përbushjen e ERA-s, diskutime për programet e BE-së për asistencë financiare për Kosovën, procesin e liberalizimit të vizave dhe strategjinë e BE-së për zgjerim.

## Komisioni Për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike ka realizuar gjithsej 27 mbledhje dhe asnjë dëgjim publik. Sipas planit të punës, komisioni kishte paraparë shqyrtimin e vetëm një projektligji, atij për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, që është i vetmi projektligj i cili i është trajtuar nga komisioni përgjatë vitit 2018. Megjithatë, komisioni ka trajtuar në detaje çështjet e ndërlidhura me procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, çështjet e ndërlidhura me diasporën, sidomos Ligjit për Diasporën, avancimin e diplomacisë parlamentare, takimet me grupet e miqësisë, si dhe thellimin e bashkëpunimit ndër-parlamentar me shtete tjera.

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike është i vetmi komision brenda Kuvendit të Kosovës që ka trajtuar Raportin mbi Arritjet dhe Sfidat në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit, i përpiluar nga Qeveria e Kosovës në qershor të 2018, dhe Projekt-Platformën Shtetërore për Finalizimin e Dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila u soll nga Qeveria më 5 qershor 2018 dhe më pas e njëjta u tërhoq. Po ashtu, komisioni ka koordinuar edhe takimet e përbashkëta mes komisioneve parlamentare për dialogun me Serbinë, aktivitet ky i përbashkët me KDI-në.

Komisioni, me planin e punës kishte parashikuar të ftojë në raportim ministrin e Punëve të Jashtme dhe ministrin e Di-

11 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistencë Teknike në Kontekst të Integritet Evropian; Projektligji nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Projektligji nr.06/L-103 për Ratifikimin e ndryshimit dhe plotësimit nr.1 të Marrëveshjes financiare për IPA 2015 në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian; si dhe Marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët".





asporës, gjë që edhe e ka realizuar. Që të dy ministrat kanë raportuar nga tri herë në komision. Për më tepër, në komision kanë raportuar edhe Ministri i Punëve të Brendshme, ish-Kryenegociatori i delegacionit qeveritar për dialog me Serbinë, Avni Arifi, si dhe Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj.

Komisioni në planin e punës për vitin 2018 kishte paraparë monitorimin e zbatimit të dy ligjeve: Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës, si dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës. Megjithatë, asnjëri nga këto dy ligje nuk është monitoruar nga ana e komisionit. Anëtarët e komisionit, megjithatë, kanë qenë aktiv në pjesëmarrje në diskutimet publike të organizuara nga Ministria e Diasporës lidhur me projektligjin për Diasporë nëpër qytete të ndryshme në Evropë dhe SHBA.

## Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport Inovacione dhe Ndërmarrësi

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport ka qenë një ndër komisionet më aktive gjatë vitit 2018, i cili ka realizuar gjithsej 51 takime, 48 prej tyre kanë qenë mbledhje të rregullta, ndërsa tritë tjera dëgjime publike.

Sipas planit të punës, komisionit për vitin 2018 kishte planifikuar të shqyrtojë të projektligjeve. Komisioni gjatë vitit 2018 ka shqyrtuar 18 projektligje, ku gjashtë prej tyre kanë qenë të parapara në planin e punës, ndërsa 12 nuk kanë qenë të parapara fare në plan të punës, prej të cilave gjashtë kanë qenë marrëveshje ndërkombëtare. Komisioni po ashtu ka planifikuar të bëjë shqyrtimin e raportit vjetor të shpenzimeve të ministrive, ndërsa ka arritur ta bëjë vetëm shqyrtimin e raportit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë. Komisioni ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për Sponsorizimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit si dhe për Ligjit për Trashëgimin Kulturorë.

Sa i përket mbikëqyrjes së ekzekutivit, komisioni ka ftuar ministratë e linjës në raportim për çështje të caktuara. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqyri Bytyqi ka marrë pjesë shtatë herë në raportim në komision, ndërsa Ministri i Inovacioneve dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, si dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, kanë raportuar nga një herë në komision.

Sipas planit të punës komisioni ka planifikuar që gjatë vitit të ftojë Këshillin e Kulturës për Trashëgimi Kulturorë si dhe Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) në raportim por që asnjëra nga këto raportime nuk është realizuar. Ndërsa, komisioni ka realizuar takime me anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA-së, si dhe me anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Komisioni po ashtu ka realizuar takim me përfaqësuesen e BE-së, ambasadorën Nataliya Apostolova. Tema e diskutimit të këtij takimi është përkrahja e BE-së për ngritjen e cilësisë në arsim.

Sipas planit të punës për vitin 2018, komisioni ka planifikuar të bëjë shqyrtimin e raportit vjetor të shpenzimeve të ministrive dhe agjencive, si në vijim: Ministrisë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministrisë së Inovacioneve dhe Ndërmarrësisë; Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë. Mirëpo, komisioni ka arritur të bëjë vetëm shqyrtimin e raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2017.

## Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 46 mbledhje të rregullta dhe tri dëgjime publike.

Nga aspekti ligjvënës, ky komision gjatë vitit 2018 ka qenë aktiv, duke shqyrtuar gjithsej 20 projektligje. Plani i punës



për vitin 2018 i këtij komisioni kishte paraparë shqyrtimit e 18 projektligjeve, përfshirë këtu edhe një marrëveshje ndërkombëtare dhe një nismë ligjore të vet komisionit. Tri nga projektligjet e parapara me plan të punës, nuk janë shqyrtuar nga komisioni pasi që ato nuk janë sjellë nga Qeveria. Ndërsa nga projektligjet e shqyrtuara në komision, vetëm dy nuk kanë arritur të marrin miratim final nga Kuvendi gjatë vitit 2018. Përveç këtyre projektligjeve të planifikuara në plan të punës, komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar edhe pesë projektligje të tjera që i ka sjellë Qeveria, ku dy prej tyre kanë qenë marrëveshje ndërkombëtare.

Sipas planit të punës, komisioni ka planifikuar t'i shqyrtojë tetë raporte vjetore të institucioneve të pavarura që i raportojnë komisionit, ku ka arritur t'i shqyrtojë të gjitha këto raporte të planifikuara. Po ashtu, sipas planit të punës, komisioni ka shqyrtuar edhe raportet e performancës të ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016. Gjatë vitit 2018, komisioni gjithashtu ka bërë përzgjedhjen e kryesuesit të bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, institucion ky i cili është nën mbikëqyrje të këtij komisioni.

Përveç në rolin ligjvënës, ky komisioni ka treguar performancë të mirë edhe në rolin e tij të mbikëqyrjes së ekzekutivit. Për vitin 2018, komisioni kishte ftuar për raportim dhjetë herë ministrat të katër ministrive të linjës. Tri herë ishte ftuar në raportim Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka, nga dy herë ishin ftuar Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, Ministri i Zhvillimit Rajonal, Rasim Demiri, si dhe Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala. Ndërkaq, një herë ishte ftuar në raportim edhe tanimë ish-Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani. Të gjitha këta anëtarë të kabinetit qeveritar i janë përgjigjur pozitivisht ftesave të komisionit për raportim.

Meqenëse puna e komisioni ka qenë më e fokusuar në përmirësimin e rolit ligjvënës, i njëjti fokus nuk ka qenë edhe në zhvillim të aktiviteteve për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë në praktikë të ligjeve në fuqi. Edhe pse edhe me plan të punës ky komision kishte paraparë mbikëqyrjen e zbatimit të vetëm një ligji për vitin 2018, komisioni nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet në këtë drejtim.

## **Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rajonal, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rajonal, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsej 29 mbledhje të rregullta, ndërkaq nuk ka mbajtur asnjë dëgjim publik.

Në planin e punës për vitin 2018, komisioni kishte paraparë shqyrtimin e 21 projektligjeve, dy prej tyre nisma ligjore të komisionit. Nga 21 projektligjetë planifikuara për shqyrtim, komisioni ka arritur të shqyrtojë vetëm nëntë prej tyre. Ndërkaq, ky komision ka shqyrtuar edhe një projektligj tjetër jashtë planit të punës, i cili ka qenë nismë ligjore e vet komisionit. Prej numrit të përgjithshëm të projektligjeve të shqyrtuara gjatë këtij viti, katër prej tyre kanë marrë miratim final nga Kuvendi, ndërkaq gjashtë të tjerë kanë mbetur në procedurë të shqyrtimit.

Nga 10 projektligjet e shqyrtuara nga ky komision, për asnjë prej tyre nuk është organizuar dëgjim publik, me qëllim të përfshirjes së palëve të interesit, shoqërisë civile dhe qytetarëve për të dhënë kontributin e tyre në projektligjet e trajtuara.

Tri raporte vjetore të institucioneve të pavarura të cilët i mbikëqyrë ky komision janë shqyrtuar gjatë vitit 2018, ashtu siç edhe ishin paraparë në planin e punës. Gjatë vitit 2018 komisioni gjithashtu ka bërë përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në Kosovë, me anë të një konkursi të hapur nga Kuvendi.

Në funksion të ushtrimit të rolit mbikëqyrës, ky komision kishte ftuar në raportim vetëm nga një herë gjatë gjithë vitit ministra nga ministratë që bien në fushëveprim të këtij komisioni. Për raportim ishin ftuar Nenad Rikallo, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Fatmir Matoshi, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së komisionit.



Me plan të punës ishte paraparë mbikëqyrja e zbatimit të tri ligjeve, dy nga sektori i bujqësisë dhe një nga sektori i ndërtimitarisë, por që komisioni nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet. Si rrjedhojë kjo pjesë e planit të punës nuk është përmbushur fare.

## Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka mbajtur 27 takime, ku 25 prej tyre kanë qenë mbledhje të rregullta, ndërsa ka organizuar vetëm dy dëgjime publike.

Komisioni për vitin 2018 ka paraparë shqyrtimin e tetëprojektligjeve. Komisioni ka shqyrtuar vetëm tringa projektligjet të parapara në planin e punës, si dhe ka shqyrtuar dy projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, që nuk kanë qenë të parapara në planin e punës për vitin 2018.

Komisioni ka shqyrtuar raportin e monitorimit të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare e cila është miratuar edhe në seancëplenare. Po ashtu, në planin e punës për vitin 2018, komisioni ka paraparë të bëjë edhe monitorimin e një ligji, por nuk është caktuar se për cilin ligj bëhet fjalë. Komisioni në muajin tetor ka formuar grupin punues për monitorimin e Ligjit për Produktet dhe Pajisjet Medicinale. Ndërsa, në plan të punës së komisionit është paraparë që të bëhet edhe mbikëqyrja e zbatimit të Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, gjë e cila nuk është realizuar. Komisioni po ashtu ka shqyrtuar raportin e performancës për Efikasitetin dhe Efektivitetin në Implementimin e Sistemit Informativ Unik të Integruar Shëndetësor.

Komisioni në masë të madhe i është përmbajtur planit të punës sa i përket mbikëqyrjes së ekzekutivit. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka raportuar tre herë, ndërsa Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka raportuar

katër herë para komisionit. Komisioni po ashtu ka zhvilluar takime me Bordin dhe drejtorin e SHSKUK-së, Shoqatën e Personave të Prekur me Fibroy Cistike, me kryeshefin e Agjencisë për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me përfaqësues nga Iniciativa e Pavarur e të Verbërve; me përfaqësues të shoqatave të sindikatave të mbrojtjes së të drejtave të pensionistëve, Kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës, Basri Ibrahim, si dhe me kryetarin e Federatës të Sindikatave të Shëndetësisë.


## Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së

Gjatë vitit 2018, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së ka zhvilluar gjithsej 24 mbledhje të rregullta dhe dy dëgjime publike. Mirëpo, brenda takimeve të mbajtura gjatë vitit nuk ka arritur ta përmbush planin e punës të paraparë për vitin 2018.

Sipas planit të punës, komisioni ka paraparë që brenda vitit t'i shqyrtojë nëntë projektligje. Komisioni ka shqyrtuar gjithsej gjashtë projektligje, ku dy prej tyre kanë qenë jashtë planit të punës, siç është Projektligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, si dhe Projektligji për Infrastrukturon Kritike.

Ndër projektligjet më kryesore që komisioni ka shqyrtuar gjatë vitit 2018 është pakoja e projektligjeve që lidhen me mandatin e ri të FSK-së. Në mënyrë që shqyrtimi i këtyre projektligjeve të jetë më gjithëpërfshirës, komisioni ka organizuar dy dëgjime publike, në Prizren dhe në Çagllavicë, me qëllim që pakoja e ligjeve për FSK-në të diskutohet me gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Sa i përket mbikëqyrjes së ekzekutivit, komisioni i është përmbajtur planit të punës. Në raportim janë ftuar ish-Ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrahman Rama, ish-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni,



ish-Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, të cilët janë përgjegjës për pozitivisht ftesës për të raportuar në komision. Komisioni po ashtu ka bërë mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin e Policisë, i cili ka qenë i paraparë edhe në plan të punës.

## Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media gjatë vitit 2018 ka mbajtur 33 takime, 30 prej tyre të rregullta dhe tri dëgjime publike.

Komisioni për vitin 2018 si një ndër aktivitetet kryesore kishte shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve të caktuara. Komisioni ka paraparë shqyrtimin dhe amendamentimin e 10 projektligjeve. Ndërsa, komisioni ka shqyrtuar gjithsej 14 projektligje, prej të cilave tetë kanë qenë të parapara në planin e punës. Komisioni po ashtu ka iniciuar edhe tri nisma ligjore, të cilat kanë qenë për plotësim ndryshimin e ligjit për KPM-në, për hartim e projektligjit të mediave të Kosovës, si dhe Projektligjin për Radio Televizionin e Kosovës.

Sipas planit të punës të komisionit, ishte paraparë raportimi i ministrave lidhur me masat e ndërmarra për përmbushjen e obligimeve në kuadër të MSA-së, por që një gjë e tillë nuk është realizuar. Ndërsa, komisioni ka realizuar takime me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, lidhur me çështjen e dixhitalizimit të transmetimeve radio-difuzive tokësore, me bordin e RTK-së, si dhe me përfaqësues të KPM-së, RTK-së dhe FFK-së, me temën "Shitja e të drejtave mediale nga UEFA në territorin e Republikës së Kosovës, nëpërmjet thirrjes për ofertim në territorin e Serbisë".

Bazuar në planin e punës, komisioni nuk ka paraparë mbikëqyrjen apo monitorimin e asnjë ligji.

Ndërsa, sipas planit vjetor të punës komisioni ka paraparë të bëjë shqyrtimin e raporteve vjetore të pesë agjencive të pavarura, ndërsa është bërë shqyrtimi i vetëm dy prej tyre.

## Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Gjatë vitit 2018 Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka mbajtur 27 takime, 26 prej tyre kanë qenë mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik. Ashtu siç parashihet edhe në planin e punës, komisioni ka shqyrtuar dhe amendamentuar vetëm një projektligj, atë lidhur me shqyrtimin dhe miratimin të raportit përfundimtar për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, për të cilin është mbajtur edhe një dëgjim publik.

Sipas planit të punës, ndër aktivitetet kryesore të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike është planifikuar që të jetë shqyrtimi i raporteve të Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, si dhe monitorimii organizatave buxhetore që bien në kompetencat të komisionit. Komisioni ka qenë mjaft aktiv sa i përket shqyrtimit të raporteve të auditimit, ku gjatë vitit 2018 komisioni ka shqyrtuar gjithsej 25 raporte të Auditimit. Komisioni po ashtu ka iniciuar procedura për auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike për vitin 2017, e cila ka qenë e paraparë edhe në planin e punës për vitin 2018.

Edhe pse puna e komisionit gjatë vitit 2018 ka qenë e koncentruar më shumë në shqyrtimin e raporteve të Auditimit, një ndër pengesat kryesore që ka ndikuar në funksionimin e mirëfillt të punës së këtij komisioni, ka qenë ngarkimi i rendit të ditës me shumë pika për t'u shqyrtuar. Rrjedhimisht edhe shqyrtimet e raporteve të auditimit nuk kanë arritur të kenë vëmendje të plotë dhe të veçantë nga komisioni.

Sa i përket mbikëqyrjes së punës së ekzekutivit, komisioni ka ftuar në raportim Ministrin e Financave, Bedri Hamza, lidhur me shpenzimet e paparashikuara për vitin 2017, Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, rreth

shqyrtimit të raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2017, si dhe Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, rreth Auditimit të pasqyrave për vitin 2017, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht ftesës së Komisionit.

## Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në vitin 2018 ka mbajtur 35 mbledhje të rregullta dhe tri dëgjime publike.

Në plan të punës për vitin 2018, komisioni kishte paraparë shqyrtimin e vetëm dy projektligjeve, të cilat i ka shqyrtuar gjatë kësaj periudhe kohore. Mirëpo, gjatë periudhës raportuese, këto projektligje nuk e kanë marrë miratimin final nga Kuvendi, si rrjedhojë kanë mbetur në procedurë të shqyrtimit për vitin 2019. Jashtë planit të punës, komisioni ka shqyrtuar edhe një nismë ligjore të propozuar nga GP VV, lidhur me Projektligjin për Peticione. Mirëpo, komisioni nuk i ka dhënë përkrahje këtij projektligji me arsyetimin që, si komision ka hartuar një draft të këtij projektligji dhe se do ta sjellë në Kuvend si nismë ligjore të komisionit. Ngjashëm sikurse me dy projektligjet e lartpërmendura, as ky projektligj nuk është hedhur në votim për lexim të parë në seancë.

Sa i përket rolit mbikëqyrës ndaj ekzekutivit, komisioni ka qenë mjaft aktiv në këtë drejtim. Për vitin 2018, komisioni kishte ftuar tetë herë në raportim ministrat e pesë ministrive. Komisioni ka ftuar dy herë në raportim Ministrin e Arsimet, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, tri herë Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reqica, si dhe nga një herë ishin ftuar për raportim Ministri i Administratës Publike, Mahir Yağcilar, Ministri i Shëndetësisë Uran Ismaili, si dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Llluka.

Komisioni ka shqyrtuar raportin e një institucioni të pavarur që e ka nën mbikëqyrje, atë për Avokatin e Popullit, siç ishte paraparë me Plan të Punës.

Sa i përket aktiviteteve për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve që bien në fushëveprimtarinë e këtij komisioni, në plan të punës ishte paraparë mbikëqyrja e tri ligjeve në fuqi. Komisioni ka bërë mbikëqyrjen për zbatimin e vetëm një projektligji, i cili ka qenë Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, duke përgatitur një raport me gjetjet e dala nga mbikëqyrja, mirëpo qëi njëjti nuk është dërguar në seancë për miratim final. Komisioni ka paraparë mbikëqyrjen edhe të dy ligjeve tjera, për të cilat nuk ka ndërmarrë asnjë aktivitet.

## Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Gjatë vitit 2018, Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ka mbajtur gjithsej 14 takime të rregullta, të cilat kanë qenë të mbyllura për publikun.

Komisioni ka ftuar rregullisht në raportim Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Komisioni ka ftuar për raportim ish-Drejtorin e AKI-së, Driton Gashi, i cili është përgjigjur pozitivisht ftesës së komisionit, duke marrë pjesë tri herë në raportim para komisionit. Ndërsa drejtori i ri i AKI-së, Shpend Maxhuni, ka marrë pjesë katër herë në raportim në komision. Në komision për raportim ka marrë pjesë tri herë edhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Shkëlzen Sopjani.

Sipas programit të punës së Kuvendit për vitin 2018, komisioni kishte paraparë të bëjë mbikëqyrjen e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, gjë e cila nuk është realizuar. Ndërsa, komisioni ka bërë shqyrtimin e kërkesës së AKI-së lidhur me përjashtimin nga fushëveprimi për Paga në Sektorin Publik. Komisioni po ashtu ka realizuar vizitë në Drejtoritë rajonale të AKI-së, ku është zhvilluar edhe diskutimi në komision lidhur me vizitat e deputetëve të realizuara në këto drejtori.

## SHTOJCA 2: Pjesëmarrja e deputetëve në Komisione Parlamentare

### Komisioni për Buxhet dhe Financa

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Lumir Abdixhiku	27	2
Safete Hadergjonaj	27	2
Ali Lajçi	27	2
Naser Osmani	25	4
Mërgim Lushtaku	24	5
Fikrim Damka	21	8
Jelena Bontic	18	11
Dardan Molliqaj	12	17
Blerim Kuçi	20	9
Enver Hoti	21	8
Arbërie Nagavci*	12	0

*Deputetja Arbërie Nagavci është bërë anëtare e Komisionit nga mbledhja e 17-të*

### Komisioni për të drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Xhelal Sveçla	20	4
Kujtim Shala	20	4
Fadil Beka	19	5
Zoran Mojsilovic	15	9
Jasmina Zivkovic	18	6
Sasa Miroslavjevic	18	6
Rasim Selmanaj	22	2
Albert Kinolli	22	2
Mufera Sinik	19	5
Danush Ademi	22	2
Duda Balje	12	12
Igor Simic	19	5
Veton Berisha*	21	1
Haxhi Shala*	17	5
Slobodan Petrovic*	16	6

*\*Deputetët Veton Berisha, Haxhi Shala dhe Slobodan Petrovic janë bërë anëtarë të Komisionit nga mbledhja e 3-të*



### Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Albulena Haxhiu	40	3
Hajdar Beqa	37	6
Bahrim Shabani	33	10
Sami Kurteshi	35	8
Arben Gashi	30	13
Korab Sejdiu	36	7
Shkumbin Demaliaj	33	10
Bilall Sherifi	32	11
Glauk Konjufca*	1	24
Frashër Krasniqi*	18	0
Nezir Çoçaj**	19	9
Igor Simic	17	26

\*Deputeti Glauk Konjufca është zëvendësuar me deputetin Frashër Krasniqi nga mbledhja e 26-të

\*\*Deputeti Nezir Çoçaj ka qenë anëtar i Komisionit nga muaji shkurt deri në muajin shtator, kur ka dorëzuar mandatin e deputetit.

### Komisioni për Integritet Evropian

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Blerta Deliu	20	2
Zenun Pajaziti	21	1
Armend Zemaj	22	0
Milaim Zeka	17	5
Fikrim Damka	17	5
Fatmire Mulhaxha	19	3
Adem Hodza	11	11
Ahmet Isufi*	9	1
Donika Kadaj*	8	4
Fitore Pacolli*	9	1
Glauk Konjufca*	0	10
Visar Ymeri*	10	2
Ismajl Kurteshi*	11	1
Ilir Deda**	15	2
Ismet Beqiri**	2	1

\*Deputetët Ahmet Isufi është zëvendësuar nga deputetja Donika Kadaj – Bujupi nga mbledhja e 11-të

\*Deputetja Fitore Pacolli është zëvendësuar nga deputeti Visar Ymeri nga mbledhja e 11-të

\*Deputeti Glauk Konjufca është zëvendësuar nga deputeti Ismajl Kurteshi nga mbledhja e 11-të

\*Deputeti Ilir Deda është zëvendësuar nga deputeti Ismet Beqiri nga mbledhja e 19-të





### Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Vjosa Osmani	27	0
Danush Ademi	21	9
Time Kadrijaj	25	2
Aida Dërguti*	13	5
Visar Ymeri*	12	6
Glauk Konjufca*	6	3
Fitore Pacolli*	7	2
Dukagjin Gorani	21	6
Doruntinë Maloku	15	12
Elmi Reçica	20	7
Evgjeni Thaçi	23	4
Zafir Berisha	22	5
Srdjan Mitrovic	12	15


\*Deputetja Aida Dërguti është zëvendësuar nga deputetja Fitore Pacolli nga mbledhja e 18-të

\*Deputeti Visar Ymeri është zëvendësuar nga deputeti Glauk Konjufca nga mbledhja e 18-të

### Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Besa Baftiu	26	1
Evner Hoti	26	1
Faton Topalli	3	9
Haxhi Avdyli	18	9
Flora Brovina	21	6
Bekim Haxhiu	21	6
Fikrim Damka	9	18
Miljana Nikolic	15	12
Fatmire Kollcaku	20	7
Naser Rugova	13	14
Time Kadria	20	7
Drita Millaku	7	8

\*Deputeti Faton Topalli është zëvendësuar me deputeten Drita Millaku në mbledhjen e 12-të.









### Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Ismajl Kurteshi	51	2
Teuta Haxhiu	53	0
Mufera Sinik	29	21
Arberie Nagavci	44	9
Albulena Balaj-Halimaj	23	20
Driton Çausi	21	3
Valentina Bunjaku-Rexhepi	22	21
Verica Ceranic	18	35
Fidan Rekaliu	28	24
Abdyl Salihu	38	15
Adem Nikollovci	25	4

\*Deputeti Adem Nikollovci është zëvendësuar me deputetin Driton Çausi në mbledhjen e 29-të.


### Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Duat Haradinaj*	15	3
Muharrem Nitaj*	11	0
Besa Gaxherri	21	8
Srdjan Mitrovic	11	18
Andin Hoti	26	3
Danush Ademi	21	8
Liburn Aliu	13	16
Ganimete Musliu	27	2
Lutfi Zharku	25	4
Salih Salihu	26	3
Salih Zyba*	12	2
Driton Çausi*	9	6
Enver Hoti*	16	3
Etem Arifi*	6	4

Deputeti Daut Haradinaj është zëvendësuar nga deputeti Muharrem Nitaj nga mbledhja e 18-të

\*Deputeti Driton Çausi është zëvendësuar nga deputeti Salih Zyba nga mbledhja e 15-të

\*Deputeti Enver Hoti është zëvendësuar nga deputeti Etem Arifi nga mbledhja e 20-të





|||||

### Komisioni për Mbikëqyrje të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Donika Kadaj - Bujupi	5	0
Anton Quni	13	1
Xhevahire Izmaku	11	3
Haxhi Shala	9	5
Ganimete Musliu	12	2
Arbër Rexhaj	10	4
Bekë Berisha	12	2
Liburn Aliu	1	8
Bahri Shabani	6	6
Teuta Rugova	0	14
Shemsi Syla	5	0
Slavko Simic	9	5

\*Deputetja Donika Kadaj Bujupi është larguar nga komisioni nga mbledhja e 6-të.

\*Deputeti Liburn Aliu është zëvendësuar me deputetin Shemsi Syla nga mbledhja e 11-të.

### Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Haxhi Shala	24	2
Rexhep Selimi	25	1
Fadil Beka	22	4
Xhelal Svecla	23	3
Bahri Shala	17	9
Fatmir Xhelili	23	3
Ismet Beqiri	16	10
Zoran Mojsilovic	17	9
Ramiz Kelmendi	1	25
Muharrem Nitaj	11	4
Shemsi Syla	4	8
Aida Dërguti	6	7
Daut Haradinaj	6	5
Drita Millaku	4	0
Blerim Kuçi	0	2

\*Deputetja Drita Millaku 2018 është zëvendësuar me deputetin Shemsi Syla nga mbledhja e 5-të.

\*Deputeti Shemsi Syla është zëvendësuar me deputeten Aida Dërguti nga mbledhja e 12-të.

\*Deputeti Blerim Kuçi është zëvendësuar me deputetin Muharrem Nitaj nga mbledhja e 3-të.

\*Deputeti Muharrem Nitaj është zëvendësuar me deputetin Daut Haradinaj nga mbledhja e 14-të.


|||||



## SHTOJCA3: Pjesëmarrja e deputetëve në seanca plenare

### NUMRI I SEANCAVE SIPAS MUAJVE

Emri dhe Mbiemri	Grupi parlamentar	NUMRI I SEANCAVE SIPAS MUAJVE												Pjesëmarrje	Mungesa
		4 (2 vazhdimë)	5 (3 vazhdimë)	12 (8 vazhdimë)	7 (3 vazhdimë)	5 (2 vazhdimë)	11 (8 vazhdimë)	14 (9vazhdimë)	6 (2 vazhdimë)	5 (3 vazhdimë)	8 (4vazhdimë)	7 (2 vazhdimë)			
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor			
ABDYLL SALIHU	PDK	2	2	12	4	5	6	7	2	4	5	6	65	18	
ADEM HODŽA	LS	2	2	10	4	5	6	5	3	2	3	1	53	30	
ADEM MIKULLOVCI	LVV	3	5	10	7	5	8	9	3	4	6	5	75	8	
MUHARREM NITAJ	AAK	3	5	12	7	5	7	9	4	5	6	6	79	4	
AHMET ISUFI	AAK	3	5	12	7	4	8	9	3	5	7	6	79	4	
AIDA DËRGUTI	PSD	2	5	9	5	5	4	7	4	5	4	5	65	18	
ALBIN KURTI	LVV	3	4	10	5	5	7	3	3	3	3	4	60	23	
ALBULENA BALAJ-HALIMAJ	NISMA	3	5	12	3	4	7	9	4	5	5	6	73	10	
ALBULENA HAXHIU	LVV	3	4	12	5	5	8	7	2	4	6	5	71	12	
ALI LAJÇI	LVV	3	3	11	7	5	8	8	3	4	6	5	73	10	
ALBERT KINOLLI	6+	3	4	11	7	5	8	9	4	4	3	6	74	9	
ANDIN HOTI	PDK	3	5	12	7	4	8	8	4	5	6	6	78	5	
ANTON QUNI	LDK	3	4	11	5	5	4	8	3	3	5	4	65	18	
ARBAN ABRASHI	LDK	3	4	12	6	5	7	8	3	2	5	3	68	15	
ARBEN GASHI	LDK	3	2	10	6	5	8	5	3	2	6	5	65	18	
ARBËR REXHAJ	LVV	3	5	12	6	5	7	9	3	4	6	5	75	8	
ARBERIJE NAGAVCI	LVV	3	5	12	7	5	7	8	2	4	5	5	73	10	
ARMEND ZEMAJ	LDK	3	3	12	7	4	7	9	3	3	6	5	72	11	
AVDULLAH HOTI	LDK	3	4	12	7	5	8	7	3	3	5	5	72	11	
BEKË BERISHA	AAK	3	5	12	6	5	8	8	4	5	5	6	77	6	
BEKIM HAXHIU	PDK	3	5	11	6	5	8	8	4	5	6	6	77	6	
BESA BAFTIU	PSD	3	5	10	6	5	7	8	4	5	5	6	74	9	
BESA GAXHERRI	LDK	3	4	11	6	1	3	6	3	3	6	5	61	22	
BILALL SHERIFI	NISMA	3	5	12	7	5	7	9	4	5	6	6	79	4	
BLERIM KUÇI	AAK	1	4	11	5	5	4	9	4	4	4	6	67	16	
BLERTA DELIU - KODRA	PDK	3	3	12	7	4	8	7	4	5	7	6	76	7	
BAHRIM ŠABANI	6+	3	5	12	7	5	8	9	4	5	7	6	81	2	
DANUSH ADEMI	6+	3	4	11	5	5	8	9	4	5	7	6	77	6	
DARDAN MOLLIQAJ	PSD	2	3	8	4	5	6	3	4	5	5	6	61	22	
DARDAN SEJDIU	PSD	3	4	11	6	5	7	6	3	4	7	6	72	11	
DAUT HARADINAJ	AAK	3	4	10	6	4	5	8	4	5	5	5	69	14	
DONIKA KADAJ - BUJUPI	AAK	2	4	10	4	5	7	6	3	5	4	6	66	17	
DORUNTINË MALOKU - KASTRATI	LDK	3	4	12	4	4	8	7	3	3	4	2	64	19	
DRITA MILLAKU	LVV	3	5	12	7	5	8	9	3	4	6	4	76	7	
DRITON ÇAUSHI	PSD	2	5	11	6	5	8	8	4	5	7	6	77	6	
DRITON SELMANAJ	LDK	3	4	10	5	4	7	6	3	3	6	5	66	17	
DUDA BALJE	6+	3	4	11	7	5	7	8	4	5	6	5	75	8	





DUKAGJIN GORANI	PSD	3	5	11	5	3	7	8	4	4	7	5	72	11
ELMI REÇICA	PDK	3	5	11	7	4	5	9	4	4	3	6	71	12
EMILJIA REDŽEPI	AAK	3	5	12	6	3	8	9	3	5	6	5	75	8
ENVER HOTI	NISMA	2	5	11	6	5	6	9	3	5	6	6	74	9
ETEM ARIFI	NISMA	3	5	11	6	4	6	9	4	5	7	6	76	7
EVGJENI THAÇI - DRAGUSHA	PDK	3	5	12	7	5	7	9	4	5	5	6	78	5
FADIL BEKA	PDK	3	5	11	6	5	8	9	4	5	7	6	79	4
FATMIR XHELILI	PDK	3	5	12	6	5	8	9	4	5	7	6	80	3
FATMIRE KOLLÇAKU	LVV	3	4	10	6	4	7	6	2	4	4	5	65	18
FATON TOPALLI	PSD	2	3	3	3	5	5	5	3	2	6	5	52	31
FIDAN REKALIU	LDK	3	4	10	7	5	7	7	3	3	5	5	69	14
FIKRIM DAMKA	6+	3	5	11	4	2	6	6	4	5	6	6	68	15
FISNIK ISMAILI	PSD	0	2	9	3	4	5	8	2	4	3	5	55	28
FITORE PACOLLI - DALIPI	LVV	3	5	11	5	4	8	7	2	3	2	4	64	19
FLORA BROVINA	PDK	3	5	12	7	5	7	5	4	5	7	6	76	7
FRASHËR KRASNIQI	PSD	0	1	11	4	5	8	8	4	5	6	6	68	15
GANI DRESHAJ	AAK	3	1	5	5	2	2	9	3	3	2	5	50	33
GANIMETE MUSLIU	PDK	3	5	12	7	4	8	7	3	5	6	6	76	7
GLAUK KONJUFCA	LVV	3	5	11	6	5	5	9	1	3	1	2	61	22
HAJDAR BEQA	PDK	3	5	12	6	3	8	8	4	5	6	6	76	7
HAXHI AVDYLI	LDK	3	3	12	6	5	7	7	3	3	6	5	70	13
HAXHI SHALA	NISMA	3	4	9	5	5	5	8	2	5	5	5	66	17
HYKMETE BAJRAMI	LDK	3	4	11	7	5	5	7	2	3	4	5	66	17
IGOR SIMIĆ	LS	3	2	9	5	5	5	6	3	4	4	0	56	27
ILIR DEDA	PA GRUP	3	4	12	4	5	5	8	4	3	6	5	69	14
IMET RRAHMANI	LDK	3	3	12	6	5	8	4	3	3	3	5	65	18
ISLAM PACOLLI	PA GRUP	3	5	11	4	5	7	6	4	5	5	6	71	12
ISMAJL KURTESHI	LVV	2	4	12	7	5	8	9	2	3	6	5	73	10
ISMET BEQIRI	LDK	1	4	11	2	5	7	5	3	3	2	5	58	25
JASMINA ŽIVKOVIĆ	LS	3	2	10	5	5	7	7	2	3	3	0	57	26
JELENA BONTIĆ	LS	3	2	10	4	5	6	5	2	4	3	0	54	29
KADRI VESELI	PDK	3	5	11	7	5	4	8	4	3	4	4	68	15
KORAB SEJDIU	LDK	3	4	12	4	5	7	8	3	3	6	5	70	13
KUJTIM SHALA	LDK	3	4	12	7	5	8	8	3	3	5	5	73	10
LABINOT TAHIRI	PA GRUP	3	3	7	3	5	7	6	3	5	4	6	62	21
LIBURN ALIU	LVV	3	4	10	7	2	4	8	2	2	3	5	60	23
LIRIJE KAJTAZI	LDK	2	2	11	7	5	7	8	3	3	5	5	68	15
LULJETA VESELAJ - GUTAJ	PDK	3	5	12	6	5	8	9	4	5	6	6	79	4
LUMIR ABDIXHIKU	LDK	3	4	12	6	5	7	7	3	3	6	5	71	12
LUTFI ZHARKU	LDK	2	3	12	5	5	8	9	3	3	6	5	71	12
MEMLI KRASNIQI	PDK	2	3	10	5	5	6	8	4	4	6	4	67	16
MERGIM LUSHTAKU	PDK	3	5	11	6	4	7	9	4	5	5	5	74	9
MEXHIDE M.JAKU - TOPALLI	PDK	3	5	12	7	5	8	8	4	5	5	6	78	5
MILAIM ZEKA	NISMA	3	4	12	6	5	7	8	4	5	6	6	76	7



DEMOKRATIZIMI DHE PRAKTIKAT PARLAMENTARE

|||||

MILJANA NIKOLIĆ	LS	3	2	10	6	5	6	8	3	4	4	0	61	22
MIMOZA KUSARI - LILA	PA GRUP	2	4	12	6	5	6	7	4	3	2	3	64	19
MIRJETA KALLUDRA	LDK	2	4	10	6	5	7	7	3	2	6	5	67	16
MUFERA SRBICA -ŠINIK	6+	2	4	12	5	2	7	7	3	5	6	6	69	14
SHEMSI SYLA	LVV	3	5	11	7	5	8	9	3	3	6	5	75	8
NAIT HASANI	PDK	3	5	11	7	5	7	9	4	5	5	6	77	6
NASER OSMANI	LDK	3	4	10	6	5	8	5	3	2	5	5	66	17
NASER RUGOVA	LDK	3	4	12	5	4	7	8	3	3	6	4	69	14
NEZIR ÇOÇAJ	PDK	3	5	12	5	5	8	9	2				59	6
SALI ZYBA	LVV	3	5	12	7	5	8	6	2	4	6	5	73	10
RAMIZ KELMENDI	LDK	1	2	5	3	5	5	4	1	0	2	1	39	44
RASIM SELMANAJ	AAK	3	4	11	7	5	8	9	4	5	5	6	77	6
REXHEP SELIMI	LVV	3	5	10	6	5	7	9	3	4	5	4	71	12
SAFETE HADËRGJONAJ	PDK	3	5	12	2	5	8	7	4	5	5	6	72	11
SALA BERISHA- SHALA	PDK	3	5	12	6	3	7	9	3	5	6	5	74	9
SALIH SALIHU	PSD	3	5	11	6	5	7	7	4	5	6	6	75	8
SAMI KURTESHI	LVV	3	4	10	7	5	8	9	3	4	5	5	73	10
SARANDA BOGUJJEVCI	LVV	3	4	9	7	3	6	7	2	2	0	1	54	29
SASA MILOSAVLJEVIĆ	LS	3	2	10	3	5	7	7	4	4	6	0	61	22
SHKUMBIN DEMALIAJ	AAK	3	5	9	7	5	7	9	4	5	6	6	76	7
SHOIQE PANTINA	PSD	3	4	10	6	5	7	6	4	5	6	6	72	11
SLAVKO SIMIĆ	LS	3	2	10	6	5	6	8	4	4	5	0	63	20
SLOBODAN PETROVIĆ	PA GRUP	3	3	11	5	4	7	8	3	5	6	4	69	14
SROJAN MITROVIĆ	LS	2	0	9	4	5	6	4	3	3	4	0	50	33
TEUTA HAXHIU	AAK	3	5	12	6	5	8	8	4	5	6	6	78	5
TEUTA RUGOVA	LDK	2	3	9	6	5	4	4	1	3	3	2	52	31
TIME KADRIJAJ	AAK	3	5	12	6	5	6	9	4	4	1	6	71	12
VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI	LDK	3	4	12	7	5	8	9	3	3	5	5	74	9
VALON RAMADANI	LVV	3	4	12	7	5	8	9	3	4	5	5	75	8
VERICA ÇERANIĆ	LS	3	2	10	5	5	6	8	3	4	5	0	61	22
VETON BERISHA	NISMA	3	5	12	5	3	5	9	4	5	7	6	74	9
VISAR YMERI	PSD	0	4	11	6	4	6	8	4	4	6	4	67	16
VJOSA OSMANI - SADRJU	LDK	3	4	11	4	5	5	4	3	3	5	2	59	24
XHAVIT HALITI	PDK	2	4	12	5	3	7	7	3	5	5	6	69	14
XHELAL SVEÇLA	LVV	3	5	12	7	5	7	9	3	3	6	3	73	10
XHEVAHIRE IZMAKU	PDK	3	5	11	3	5	6	8	4	5	5	6	71	12
ZAFIR BERISHA	NISMA	2	4	8	6	5	7	8	4	4	6	6	70	13
ZENUN PAJAZITI	PDK	3	5	10	6	5	7	8	4	5	6	6	75	8
ZORAN MOJSILOVIĆ	LS	3	2	10	5	5	5	8	3	4	4	0	59	24

Numri total i mungesave 1671

Mesatarja e mungesave për deputetë 13.93

|||||

